



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 737Akti

Nr. 776 Vendimi
Tiranë, më 24.6.2024

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Olsi Komici Kryesues
Brunilda Bektoshi Relatore
Suela Zhegu Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Albana Plaka, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Marie Tuma, në datën 24.6.2024, ora 12:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancën dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Majlinda Miska**, me detyrë ndihmëse ligjore¹ pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b, paragrafi 5, neni Ç, paragrafi 1 dhe nenet D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998”;

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

¹ Përfaqësuar personalisht, si dhe nga av. Irena Reso, me nr. licence ***.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoji arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, komisioneres Brunilda Bekteshi, mori në shqyrtim dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Znj. Majlinda Miska, me detyrë ndihmëse ligjore pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, referuar pikës 4 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio* nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni).

2. Referuar neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK, ish-Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar); Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ).

3. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit”, Komisioni ka zhvilluar shortin në datën 15.6.2021, në përfundim të të cilit rezultoi që subjekti i rivlerësimit Majlinda Miska do t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Suela Zhegu, Brunilda Bekteshi dhe Olsi Komici. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionere Brunilda Bekteshi.

4. Komisioni, me vendimin nr. 1, datë 21.6.2021, të trupit gjykues, vendosi të fillojë hetimin administrativ sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit Majlinda Miska, si dhe caktoi kryesues të trupit gjykues komisionerin Olsi Komici. Anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit.

5. Subjektit iu komunikua në rrugë elektronike përbërja e trupit gjykues, duke iu bërë me dije e drejta për t’u shprehur lidhur me konfliktin e interesit. Subjekti i rivlerësimit, sipas kërkesës së Komisionit, në datën 9.7.2021, ka deklaruar mungesën e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues.

6. Në datën 7.6.2024, Komisioni, me vendimin nr. 2, vendosi: (i) të përfundojë hetimin administrativ kryesisht për subjektin e rivlerësimit Majlinda Miska për të tria kriteret e rivlerësimit, vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale, bazuar në rezultatet e hetimit të paraqitura nga relatorja e çështjes; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit kryesisht dhe të paraqesë pretendimet e saj brenda datës 18.6.2024 nga marrja e njoftimit me postë elektronike, për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

7. Në datën 11.6.2024, subjekti i rivlerësimit u njoftua lidhur me: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016; (iii) të sjellë prova për të provuar të kundërtën e konstatimeve të Komisionit. Në datën 18.6.2024, subjekti dërgoi në rrugë elektronike shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ.

8. Trupi gjykues, në datën 20.6.2024, me vendimin nr. 3 vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit Majlinda Miska në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016. Në datën 20.6.2024, subjekti i rivlerësimit u njoftua se seanca dëgjimore do të zhvillohej më 24.6.2024, në orën 12:00, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë.

II. SEANCA DËGJIMORE

9. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit Majlinda Miska u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare Marie Tuma. Gjatë seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit shprehu qëndrimin lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe me procesin e rivlerësimit të kryer nga Komisioni. Në përfundim të parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

10. Në përfundim të seancës dëgjimore, bazuar në pikën 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Majlinda Miska. Trupi gjykues ndërpreu seancën dëgjimore të datës 24.6.2024, për të rifilluar po më 24.6.2024 për shpalljen e vendimit në orën 12:45.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

11. Znj. Majlinda Miska ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit, duke u përgjigjur, kur është kërkuar, sipas afatit të përcaktuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ të zhvilluar ndaj saj.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

12. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues, i cili mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” sipas krerëve IV, V dhe VI të këtij ligji. ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të paraqitur një raport me konstatime në lidhje me vlerësimin pasuror. AKSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, duke paraqitur në Komision një raport me konstatimin në lidhje me përshtatshmërinë apo papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit. KLGJ-ja është organi ndihmës i ngarkuar me ligj për të paraqitur një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar në lidhje me vlerësimin profesional. Referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese² dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, Komisioni realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, i cili nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

² Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas pikës 5 të nenit 179/b të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit nr. 84/2016: “Komisioni dhe Kolegji i Posaçëm i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit nr. 84/2016 parashikohet se: “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Posaçëm i Apelit, Komisioneri Publik, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se: “Në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues, organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

A. VLERËSIMI I PASURISË

Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

13. ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar raportin e hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit Majlinda Miska, me nr. *** prot., datë 30.3.2018, në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, ku më parë subjekti në datën 27.1.2017, referuar ligjit nr. 84/2016, ka dorëzuar deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar *Vetting*. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, si për subjektin e rivlerësimit, ashtu edhe për personat e lidhur me të, për vlerësimin e pasurisë ky institucion ka konstatuar se: deklarimi nuk është i saktë dhe në përputhje me ligjin; ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; nuk ka kryer fshehje të pasurisë; nuk ka kryer deklarim të rremë; subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

14. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklarinimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të bëra me anë të komunikimit elektronik; (ç) shpjegimet me shkrim dhe dokumentacionin mbështetës të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, pas mbylljes së hetimit administrativ; si dhe (d) shpjegimet e dhëna në seancë dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

15. Komisioni hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr. 84/2016, hetim i cili konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklarinimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe të personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe të shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose në përdorim; (iv) evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarinimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuar nga pika 5 e nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

16. Mbi pasuritë e deklaruara në deklaratën *Vetting*, sipas formularit (shtojca nr. 2), datë 27.1.2017, nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, nga hetimi rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj kanë deklaruar në deklaratën *Vetting* pasuritë si vijon:

17. Apartament banimi me sipërfaqe totale 56.7 m², sipërfaqe e përbashkët 9.3 m², në adresën Y, Tiranë, me nr. pasurie *, z. k. ***, të dhëna këto sipas certifikatës së pasurisë nr. ***, lëshuar në datën 15.5.2015. Vlera: 4,587,000 lekë. Pjesa takuese: 100%.**

a. Pjesërisht me kredi, kjo sipas kontratës noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.9.2012, me kredidhënës BKT, dega “****”, Tiranë. Totali i kredisë në shumën 2,847,600 lekë.

b. Pjesërisht nga shitja e shtëpisë së prindërve në Gjirokastrë në vlerën 4,000,000 lekë, kjo shumë është transferuar në llogarinë e saj personale, mandati bashkëngjitur. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente³.

17.1 ILDKPKI-ja në raportin e saj është shprehur: *Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar, si dhe me përgjigjen e ardhur nga DPPPP-ja dhe nga ZVRPP-ja Tiranë.*

Hetimi i Komisionit

17.2 Kjo pasuri është deklaruar për herë të parë në deklaratën *Vetting*, pasi subjekti ka nisur ushtrimin e detyrës në korrik të vitit 2015 dhe është bërë subjekt deklarues vetëm në këtë deklaratë.

17.3 ZVRPP-ja⁴ Tiranë ka konfirmuar se znj. Majlinda Miska (Mosho) ka të regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme pasurinë nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, lloji i pasurisë apartament me sip. 56.7 m².

17.3.1 ZVRPP ka përcjellë dokumentacionin përkatës të kësaj pasurie (kartelë pasurie, kontratë shitblerjeje dhe kontratë porosie), nga ku rezulton se pasuria është përfituar nëpërmjet kontratës së shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 5.5.2015. Çmimi i kontratës është 4,587,000 lekë, shumë e cila është likuiduar sipas kontratës së porosisë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 9.6.2012.

17.3.2 Në këtë kontratë porosie të lidhur mes subjektit të rivlerësimit Majlinda Mosho (mbiemri i vajzërisë) dhe shoqërisë së ndërtimit “****” sh.p.k. për blerjen e një apartamenti, në nenin 3 është përcaktuar çmimi dhe mënyra e pagesës për apartamentin. Çmimi i apartamentit konfirmohet në vlerën 4,587,000 lekë dhe pagesa rezulton e ndarë në këste: (i) kësti i parë 200,000 lekë është paguar në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate; (ii) kësti i dytë është vlera totale e kredisë së përfituar nga porositësi në llogari të investitorit nëpërmjet BKT-së; (iii) kësti i tretë do të kryhet në momentin e marrjes në dorëzim të apartamentit, në kuptimin me çelësa në dorë; (iv) kësti prej 300,000 lekësh si pjesë e vlerës totale të kontratës do të kryhet në momentin e nënshkrimit të kontratës përfundimtare të shitblerjes.

17.4 RNSH-ja⁵ ka konfirmuar kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 5.5.2015.

17.5 DPPPP-ja⁶ konfirmon se për znj. Majlinda Miska ka raportime të kontratave noteriale: (i) në datën 9.6.2012 ka porositur një apartament në shumën 33,000 euro nga shoqëria “****” sh.p.k., përfaqësuar nga shtetasi A.Ç, sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol.; (ii) në datën 5.5.2015 ka blerë një apartament në shumën 4,587,000 lekë nga shtetasi A.Ç, përfaqësues i shoqërisë “****” sh.p.k., sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol.

³ Kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 5.5.2015, për blerje apartamenti në K, vlera 4.587.000 lekë. Palë shitëse shoqëria “****” sh.p.k. dhe palë blerëse Majlinda Mosho. Certifikatë pronësie e kartelë pasurie ZVRPP Tiranë, datë lëshimi 24.4.2015, kartela e pasurisë nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, Y. Kontratë porosie nr. *** rep., nr. *** kol., datë 9.6.2012, për apartamentin me sip. ndërtimi 66 m², në Y, vlerë 33.000 euro e konvertuar në 4.587.000 lekë. Palë investitore shoqëria “****” sh.p.k. dhe porositës Majlinda Mosho, bashkëlidhur leja e ndërtimit nr. ***, datë 3.2.2011, e komunës K. Certifikatë pasurie e apartamentit sip. 56.7 m², në Y, me nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, lëshuar në datën 15.5.2015, në emër të Majlinda Moshos, si dhe kartela e pasurisë. Kontratë shitjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.12.2014, të apartamentit me sip. 82 m², çmim shitjeje 4.000.000 lekë. Palë shitëse P.M, palë blerëse L.M, si dhe bashkëlidhur: mandat transferimi datë 24.12.2014, i BKT-së, se transferon për shitje prone nr. *** në favor të P.M shumës 4.000.000 lekë; mandatpagesë datë 26.12.2014 për kalim të shumës 4.000.000 lekë nga P.A.M, te Majlinda P. Mosho (aneks nr. 4/2, administruar në dosjen e ILDKPKI-së).

⁴ Me shkresën nr. *** prot., datë 13.11.2017, administruar së bashku me dokumentacionin përkatës me shkresën e ZQRPP-së, nr. *** prot., datë 16.11.2017 (aneksi nr. 28, administruar në dosjen e ILDKPKI-së).

⁵ Me shkresën nr. *** prot., datë 27.7.2021, administruar në dosjen e Komisionit.

⁶ Me shkresën nr. *** prot., datë 27.4.2017, administruar në dosjen e ILDKPKI-së/aneksi nr. 34.

17.6 UKT-ja⁷ ka informuar se në emër të shtetases Majlinda P. Miska nuk rezulton asnjë e dhënë apo kontratë e regjistruar me Shërbime Ujësjetës - Kanalizime sh.a.

17.7 FSHU-ja⁸ ka informuar se në emër të shtetases Majlinda P. Miska nuk rezulton asnjë e dhënë apo kontratë e regjistruar.

17.7.1 Subjekti⁹ ka depozituar kontratat përkatëse të lidhura me UKT-në dhe OSHEE-në¹⁰, nga ku konstatohet se janë të lidhura në emër të saj, me status aktiv, konsum familjar dhe jodebitore.

Lidhur me analizimin e burimeve të krijimit dhe pagesat e kryera për këtë pasuri

17.8 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *Vetting* se si burim krijimi për këtë pasuri ka shërbyer pjesërisht kredia e marrë në BKT dhe pjesërisht nga shitja e shtëpisë së prindërve në Gjirokastër, në vlerën 4,000,000 lekë.

17.8.1 Komisioni hetoi për secilin nga burimet e deklaruara dhe i rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka përfutur të drejtën për të marrë një kredi¹¹ të butë për strehim nga Bashkia e Tiranës sipas vendimit nr. ***, datë 15.4.2012, të Këshillit Bashkiak të Tiranës.

17.8.2 Subjekti ka nënshkruar kontratën e kredisë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.9.2012, me palë kredidhënëse Banka Kombëtare Tregtare, për shumën 2,847,600 lekë, me interes të ulët dhe të drejtë likuidimi për 240 muaj. Garanci për këtë kredi sipas nenit 9 të kontratës së kredisë është vendosur “Depozita bankare me titullar znj. Majlinda Mosho në shumën totale 3,133,000 lekë”. Gjithashtu, në po të njëjtën datë, subjekti ka lidhur edhe marrëveshjen siguroese¹² për marrjen e vlerës së kredisë. Në pikën 1 të marrëveshjes “Krijimi i barrës dhe detyrimit të siguruar” citohet: “*Barrëdhënësi në këtë marrëveshje vendos në favor të Bankës/barrëmarrëse një barrë siguroese:1) depozitë bankare me titullar znj. Majlinda Mosho në shumën totale 3,133,000 lekë*”. Gjithashtu, në pikën 3.1 të kësaj marrëveshjeje përcaktohet se vlera totale 3,133,000 lekë do të barrësohet në favor të BKT-së, për të garantuar kredinë e marrë nga shtetasja Majlinda Mosho të vlerës 2,847,600 lekë. Në marrëveshjen siguroese cilësohet se barra siguroese në vlerë monetare do të jetë deri në momentin e zëvendësimit të këtij kolaterali me pasuri të paluajtshme (pajisjes me “Aktin e pronësisë” dhe kalimin e saj në emër të bankës BKT si barrë siguroese për pagesën e kredisë).

17.8.3 Në aktet e administruara në dosjen e kredisë rezulton se është kryer zëvendësimi i kolateralit pas nënshkrimit të kontratës së shitjes dhe marrjes së certifikatës së pronësisë. Subjekti i rivlerësimit ka nënshkruar kontratë hipotekimi nr. *** rep., nr. *** kol., datë 1.8.2015, duke vendosur në favor të bankës apartamentin objekt vlerësimi me sip. 56.7 m², me numër pasurie ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***.

17.8.4 Nga analizimi i llogarisë së subjektit të rivlerësimit në BKT, rezultoi se kjo e fundit ka depozituar në datën 3.9.2012 shumat 2,500,000 lekë dhe 613,000 lekë. Totali i tyre (3,133,000 lekë) në datën 4.9.2012 është kaluar në depozitë me afat. Pas këtyre transaksioneve, në datën 13.9.2012 është disbursuar kredia në vlerën 2,847,600 lekë dhe po në këtë datë shuma 2,800,000 lekë është transferuar në llogarinë e shoqërisë “****” sh.p.k., me përshkrimin “Pagesë

⁷ Me shkresën nr. *** prot., datë 16.7.2021, administruar në dosjen e Komisionit.

⁸ Me shkresën nr. *** prot., datë 25.3.2021, administruar në dosjen e Komisionit.

⁹ Me pyetësorin nr. 2, datë 30.4.2024, administruar në dosjen e Komisionit.

¹⁰ Kontrata për furnizimin me ujë nr. *** dhe kontrata për furnizimin me energji elektrike nr. ***, administruar nga Komisioni.

¹¹ Shkresë nga BKT-ja nr. *** prot., datë 5.8.2021 dhe dokumentacioni bashkëlidhur, administruar nga Komisioni.

¹² Nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.9.2012, depozituar në dokumentacionin e bankës BKT, administruar nga Komisioni.

e kështit të dytë për blerjen e apartamentit sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 9.6.2012”.

17.9 Lidhur me barrën siguroese prej 3,133,000 lekësh, të vendosur për përfitimin e kësaj kredie, subjekti i rivlerësimit në pyetësin standard ka sqaruar se: *“...Për përfitimin e kredisë duhet të vendosja kolateral/barrë siguroese si garanci për përmbushjen dhe shlyerjen e kredisë. Në kushtet e pamundësisë për të gjetur një garanci bankare/kolateral të llojit pasuri të paluajtshme, kam plotësuar barrën siguroese në vlerë monetare deri në momentin e zëvendësimit të këtij kolaterali me pasuri të paluajtshme (pajisjes me “Aktin e pronësisë” së apartamentit të porositur). BKT kishte vendosur si kusht të vlerës që duhet të barrësohej në favor të saj shumën 3,133,000 lekë. Për të plotësuar këtë vlerë, kam marrë borxh nga ndërtuesi shumën totale 2,217,400 lekë. Me deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.7.2012, provohet se kam marrë borxh në vlerën 717,400 (shtatëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e katërqind) lekë dhe me deklaratën e thjeshtë të datës 3.9.2012 provohet se kam marrë borxh në vlerën 1,500,000 (një milion e pesëqind mijë) lekë nga z. A.Ç¹³”.*

17.9.1 Nga hetimi ka rezultuar se shuma e vendosur barrë siguroese është investuar në depozitë me afat në datën 4.9.2012. Kjo shumë ka gjeneruar interesa, të cilët janë përfituar prej subjektit, por depozita nuk është prekur prej saj, deri në momentin e zëvendësimit të kolateralit. Pas nënshkrimit të kontratës së shitjes (datë 5.5.2015), subjekti ka transferuar në llogarinë e saj rrjedhëse, në datën 14.8.2015, shumën 3,152,918.15 lekë (shuma e investuar depozitë, plus interesat e përfituar). Po në këtë datë, subjekti i ka transferuar shoqërisë shumën 3,009,500 lekë, me përshkrimin “Majlinda P. Mosho për *** sh.p.k., likuidim detyrimi sipas aktit të nënshkruar me ***, për detyrimin 2,996,000 lekë për kontratën e shitblerjes së apartamentit”.

17.9.2 Gjatë hetimit¹⁴, subjekti ka shpjeguar se: *“Vlera 2,996,000 lekë është paguar për pagesën e borxhit 2,217,400 lekë, është likuiduar kësti i fundit i pagesës së apartamentit në vlerë 778,600 lekë dhe diferenca 13,500 lekë i përket pagesës së kontratës së UKT-së”.*

17.9.3 Gjithashtu, subjekti ka qartësuar edhe mbi kalimin e shumës tek shoqëria “****” sh.p.k. në favor të huadhënësit, z. A.Ç, duke konfirmuar se ky i fundit është ortaku i vetëm dhe administrator i dy shoqërive, përkatësisht me të dhëna: shoqëria “****” sh.p.k., me numër unik identifikimi *** dhe shoqëria “****” sh.p.k., me numër unik identifikimi ***.

17.9.4 Komisioni hetoi për këtë fakt dhe në bazë të dokumentacionit të aksesuar në faqen zyrtare të QKB-së¹⁵ konstatoi se shtetasi A.Ç është ortaku i vetëm dhe administrator i shoqërisë “****” sh.p.k., si dhe i shoqërisë “****” sh.p.k.

17.10 Në vijim, Komisioni analizoi burimin e krijimit të secilës shumë të marrë hua nga shtetasi Ç, administrator i shoqërisë “****” sh.p.k., për vendosjen e barrës siguroese. Më konkretisht, në analizë të deklaratave të depozituara, Komisionit i rezultoi se:

i. Sipas deklaratës noteriale¹⁶ datë 18.7.2012, subjekti i rivlerësimit ka marrë hua nga shtetasi A.Ç vlerën monetare 717,400 lekë.

¹³ Me përgjigjet e pyetësorit standard datë 9.7.2021, subjekti ka depozituar deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.7.2012 dhe deklaratën e thjeshtë, datë 3.9.2012.

¹⁴ Me pyetësin standard dhe pyetësin nr.2, datë 30.4.2024, administruar në dosjen e Komisionit.

¹⁵ Ekstrakt i depozituar edhe nga subjekti i rivlerësimit me pyetësin standard.

¹⁶ Nr. *** rep., nr. *** kol., depozituar në dokumentacionin e bankës BKT, administruar nga Komisioni.

ii. Sipas deklaratës së thjeshtë datë 3.9.2012¹⁷, shtetasi Ç. deklaroi se i ka dhënë hua subjektit të rivlerësimit për të plotësuar barrën siguroese shumë 1,500,000 lekë.

iii. Lidhur me burimin e krijimit të këtyre shumave, subjekti ka sqaruar dhe dokumentuar¹⁸ se shtetasi A.Ç është ortak i vetëm dhe administrator i dy shoqërive, shoqërisë “***” sh.p.k., me numër unik identifikimi *** dhe shoqërisë “****” sh.p.k., me numër unik identifikimi ***. Në kohën kur janë marrë huat, ndërtuesi ka pasur aktivitet të vazhdueshëm për shitjen e apartamenteve dhe njësisve tregtare në dy objektet e ndërtuara dhe përfunduara në atë periudhë, rrjedhimisht ka pasur likuiditete, si dhe të ardhura personale nga aktiviteti i kryer, fakt që provon se ai ka pasur mjaftueshëm të ardhura për të 7mundësuar dhe dhënien e borxhit. Subjekti ka depozituar edhe deklaratën noteriale¹⁹ të lëshuar nga ndërtuesi A.Ç, në të cilën ai shprehet në mënyrë të detajuar për pagesën e kësteve, kushtet e vendosjes së kolateralit, si dhe disponimin e burimeve të ligjshme nga aktiviteti.

17.10.1 Komisionit, në verifikim të dokumentacionit të depozituar, i rezultoi se shtetasi A.Ç është administrator dhe ortak i vetëm i shoqërive “****” sh.p.k. dhe “****” sh.p.k. Rezulton se shoqëria “****” sh.p.k. ka një kapital në vlerën 33,100,000 lekë. Nga verifikimi i bilancit të kësaj shoqërie për vitin 2012, vit në të cilin është dhënë huaja në shumë 2,217,400 lekë, rezultoi se kjo shoqëri e ka pasur totalin e të ardhurave nga shitjet në shumë 63,582,405 lekë. Ndërsa zëri “Kërkesa të arkëtueshme” është në vlerën 4,637,900 lekë. Ndërsa shoqëria “****” sh.p.k. ka një kapital në vlerën 40,076,000 lekë. Nga verifikimi i bilancit të kësaj shoqërie për vitin 2012, rezultoi se kjo shoqëri e ka pasur totalin e të ardhurave nga shitjet në shumë 29,678,009 lekë. Ndërsa zëri “Kërkesa të arkëtueshme” është në vlerën 7,814,681 lekë.

17.10.2 Komisioni, në analizë të të dhënave të përfituara, duke konstatuar se jo vetëm të ardhurat nga shitjet rezultojnë në një vlerë të konsiderueshme në të dyja shoqëritë, por edhe vlerat në zërin e kërkesave të arkëtueshme rezultojnë më të larta sesa shuma e dhënë hua, vlerëson se provohet burimi i shumës së dhënë hua nga z. Ç.

17.11 Në lidhje me burimin tjetër të krijimit të pasurisë, të ardhurat e përfituara nga shitja e pasurisë së prindërve të subjektit në Gjirokastrë, Komisionit i rezultoi se sipas kontratës së shitjes²⁰ nr. *** rep., nr. *** kol, datë 15.12.2014, babai i subjektit të rivlerësimit P.M i ka shitur pasurinë e tij nr. ***, apartament me sip. 82 m², të ndodhur në Gjirokastrë, në shumë 4,000,000 lekë, shtetasit L.M.

17.11.1 Nga hetimi rezultoi se në llogarinë bankare të shtetasit P.M (babai i subjektit) në BKT, është transferuar në datën 24.12.2014, shuma 4,000,000 lekë nga noteri publik, me përshkrimin “F.SH transferon për shitje prone nr. *** në favor të P.M”. Ndërsa në datën 26.12.2014 shuma prej 4,000,000 lekësh i është kaluar subjektit të rivlerësimit me përshkrimin “P.M transferon për Majlinda Moshon”. Subjekti i rivlerësimit, pas përfitimit të kësaj shume nga babai i saj, ka tërhequr në datën 29.12.2014 shumë 2,200,000 lekë.

17.11.2 Subjekti ka deklaruar²¹ se pas shitjes së apartamentit në Gjirokastrë prindërit e saj kanë jetuar fillimisht për 4 muaj me të dhe bashkëshortin, dhe në vazhdim ata jetojnë në apartamentin objekt hetimi, me vendndodhje në Y, Tiranë.

¹⁷ Depozituar me pyetësorin standard, administruar në dosjen e Komisionit.

¹⁸ Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, datë 30.4.2024, administruar në dosjen e Komisionit.

¹⁹ Deklaratë noteriale e lëshuar nga ndërtuesi A.Ç nr. *** rep., datë 7.5.2024, administruar në dosjen e Komisionit.

²⁰ Aneks nr. 4/2 në dosjen e ILDKPKI-së.

²¹ Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, datë 30.4.2024, administruar në dosjen e Komisionit.

17.11.3 Pavarësisht se shitja e pasurisë së prindërve të subjektit në qytetin e Gjirokastrës është kryer nëpërmjet noterit publik dhe nga ASHK-ja nuk konfirmohen pasuri të tjera në emër të tyre, Komisioni i ka kërkuar subjektit²² të deklarojë e dokumentojë pagesën e tatimit për të ardhurat e përfituara.

17.11.4 Subjekti ka deklaruar se për pasurinë nr. ***, apartament, me sip. 82 m², në emër të babait të saj P.M është kryer rivlerësimi i pronës në vlerën 4,004,470 lekë. Ajo ka shpjeguar se ky deklarim faktohet edhe nga përmbajtja e nenit “Objekti” të kontratës së shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.12.2014, në të cilën citohet: “*Është bërë RVP në shumën 4,004,470 lekë*”. Subjekti ka qartësuar se pasi prona është rivlerësuar, kjo e dhënë është pasqyruar rregullisht në regjistrat hipotekorë pranë ish-ZVRPP Gjirokastrë. Në vijim të parashtrimit të saj ka deklaruar se nëse i referohemi kontratës së shitjes, nenit “Çmimi i shitjes”, rezulton se kjo pronë është shitur në vlerën 4,000,000 lekë dhe, në kushtet kur çmimi i shitjes është më i vogël se çmimi i rivlerësuar i pasurisë, rrjedhimisht shitësit nuk i lind detyrimi për të paguar tatim mbi të ardhurat nga shitja, për sa kohë provohet se është kryer pagesa e tatimit për RVP në shumën 4,004,470 lekë. Subjekti ka shpjeguar se ish-ZVRPP (sot ASHK), veç të tjerash, është edhe në rolin e agentit tatimor të llogaritjes dhe mbajtjes së tatimit nga shitja dhe, për sa kohë që prona e shitur ka qenë me certifikatë pronësie në momentin e kryerjes së shitjes, rrjedhimisht pagesa mbi tatimin është veprimi i cili paraprin kalimin e pronësisë tek blerësi, çka dikton në rastin konkret se prona objekt shqyrtimi nuk ka sjellë detyrime tatimore shtesë në kohën e shitjes. Subjekti ka konfirmuar se pagesa e tatimit në lidhje me rivlerësimin e pronës evidentohet të jetë kryer në shumën totale 16,680 lekë në favor të ZVRPP Gjirokastrë. Ajo ka depozituar mandatin e arkëtimit nr. ***, datë 30.4.2012 dhe ka deklaruar se ky tatim është llogaritur nga ish-ZVRPP Gjirokastrë sipas faturës për arkëtim nr. ***, datë 30.4.2012, të lëshuar nga ZVRPP-ja, të cilën gjithashtu e ka bashkëngjitur. Po ashtu, subjekti në përgjigje të këtij pyetësoi ka depozituar edhe kontratën e shitjes së pasurisë, si dhe dokumentacionin hipotekor të saj.

17.11.5 Komisioni, bazuar në të dhënat faktiko-ligjore të kësaj çështjeje, konstatoi se provohet burimi i ligjshëm i krijimit të këtyre të ardhurave, të cilat vijnë si rezultat i shitjes së një pasurie të paluajtshme ku tjetërsimi ka kaluar nëpërmjet noterit publik konform legjislacionit në fuqi në kohën e kryerjes së veprimit.

17.12 Komisioni hetoi në lidhje me shlyerjen e kësteve të kësaj pasurie, burimin e krijimit të shumave, në raport edhe me kalendarin e pagesave sipas kontratës së porosisë datë 9.6.2012.

17.13 Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar se si burim krijimi për këtë pasuri ka shërbyer:

a. Pjesërisht kredi, sipas kontratës noteriale nr. *** rep., nr. *** kol, datë 11.9.2012, me kredidhënës BKT, dega “***”, Tiranë. Totali i kredisë në shumën 2,847,600 lekë.

b. Pjesërisht nga shitja e shtëpisë së prindërve në Gjirokastrë, në vlerën 4,000,000 lekë, kjo shumë është transferuar në llogarinë personale të subjektit, mandati bashkëngjitur.

17.14 Sipas kontratës së porosisë pagesat do të bëheshin:

i) Kësti i parë 200,000 lekë është paguar në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate;

²² Me pyetësorin datë 23.5.2024, administruar në dosjen e Komisionit.

- ii) Kësti i dytë është vlera totale e kredisë së përfutur nga porositësi në llogari të investitorit nëpërmjet BKT-së;
- iii) Kësti i tretë do të kryhet në momentin e marrjes në dorëzim të apartamentit, në kuptimin me çelësa në dorë;
- iv) Kësti prej 300,000 lekësh si pjesë e vlerës totale të kontratës do të kryhet në momentin e nënshkrimit të kontratës përfundimtare të shitblerjes.
- v) Në pyetësorin standard, subjekti ka deklaruar të njëjtin burim krijimi si në deklaratën *Vetting*, pra pjesërisht kredinë dhe pjesërisht nga shitja e shtëpisë nga prindërit e saj.
- vi) Por sipas deklaratës noteriale nr. *** rep., nr. ***, kol. s'ka, datë 10.7.2012²³, konstatohet se shtetasi A.Ç në cilësinë e administratorit të shoqërisë së ndërtimit “****” sh.p.k. ka deklaruar se ka marrë nga subjekti i rivlerësimit Majlinda Mosho vlerën 717,400 lekë për efekt të shitjes së apartamentit objekt hetimi, sipas kontratës së porosisë datë 9.6.2012, lidhur mes tyre.

Subjekti ka deklaruar²⁴ se si burim krijimi për këtë shumë kanë shërbyer kursimet e krijuara në formën *cash* si rrjedhojë e punës së kryer pranë tri institucioneve ATSH, ALUIZNI, dhe AKSHI. Subjekti ka sqaruar se këto kursime mbaheshin nga babai i saj dhe se merreshin/përdoreshin nga ajo sipas nevojës. Subjekti ka depozituar dokumentacion mbi të ardhurat ndër vite të punës së saj.

vii) Komisioni konstatoi mospërputhje në deklarime në lidhje me pagesat e kryera. Në përgjigjen e saj²⁵, subjekti ka deklaruar se: *“Pagesa e vlerës së apartamentit është kryer në disa këste. Palët me vullnetin e tyre kanë respektuar këstet e pagesës, ndërsa kanë rënë dakord që kësti i fundit të paguhet në momentin e zëvendësimit të kolateralit”*.

Tabela nr. 1

Data e transaksionit	Vlera e këstit	Mënyra e kryerjes së pagesës
Kësti I: 8.6.2012	200,000	Parashikuar në nenin 3.1 të kontratës
Kësti II: 10.7.2012	717,400	Mandatarkëtimi nga shoqëria, nr. ***, datë 10.7.2012, deklarata noteriale nr. ***, datë 10.7.2012
Kësti III: 18.9.2012	2,800,000	Transfertë në BKT (shuma e kredisë)
Kësti IV: 14.8.2015	778,600	Transfertë në BKT (shuma totale e pagesës *** që përfshin borxhin 2,217,400 dhe diferenca e kontratës UKT 13,500 lekë)
Totali i likuiduar	4,496,000	

Për këstet e paguara të blerjes së apartamentit subjekti ka depozituar edhe dokumentacion²⁶.

17.15 Komisioni kërkoi²⁷ informacion dhe dokumentacion ligjor (fatura, transaksione bankare) nga shoqëria e ndërtimit “****” sh.p.k. lidhur me kryerjen, mënyrën, si dhe vlerën e pagesës për blerjen e apartamentit nga subjekti i rivlerësimit. Shoqëria e ndërtimit “****” sh.p.k. në përgjigje

²³ Depozituar nga subjekti i rivlerësimit në përgjigjet e pyetësorit standard, administruar nga Komisioni.

²⁴ Në pyetësorin nr. 2, datë 30.4.2024, administruar në dosjen e Komisionit.

²⁵ Në pyetësorin nr. 2, datë 30.4.2024, administruar në dosjen e Komisionit.

²⁶ 1. Kësti 1, shuma 200,000 lekë, burim i krijimit kursimet e të ardhurave nga pagat, e cila provohet me tërheqjen *cash* të kryer në datën 8.6.2012 pranë Alpha Bank; 2. Kësti 2, shuma 717,400 lekë, mandatarkëtimi nga shoqëria nr.***, datë 10.7.2012, deklarata noteriale nr. ***, datë 10.7.2012; 3. Kësti 3, shuma 2,800,000 lekë (shuma e kredisë), transfertë në BKT; 4. Kësti 4, shuma 778,600 lekë, transfertë në BKT (shuma totale e pagesës 3,009,500 lekë, që përfshin borxhin 2,217,400 lekë dhe diferenca e kontratës UKT 13,500 lekë).

²⁷ Me shkresën nr. *** prot., datë 12.2.2024, administruar në dosjen e Komisionit.

të saj informon²⁸ se: “Znj. Majlinda Miska (Mosho) ka porositur dhe ka likuiduar sipas afateve apartamentin pranë shoqërisë sonë dhe likuidimi ka qenë korrekt. Për arsye se firma nuk ka aktivitet, si dhe ekonomistja është me leje lindjeje, për momentin nuk mund të shoqërohet informacioni me dokumentacion”.

17.16 Subjektit i është kërkuar të saktësojë vlerën e diferencës së mbetur për të plotësuar shumën e barrës siguroese 3,133,000 lekë në raport me huan e marrë shtetasit A.Ç, si dhe të deklarojë e dokumentojë burimin e krijimit të saj.

17.16.1 Në përgjigje të saj, subjekti ka sqaruar se: “Diferenca midis vlerës së kushtëzuar nga banka dhe borxhit të marrë rezulton në vlerën 915,600 lekë, e cila ka si burim të krijimit: (i) shumën 225,000 lekë, sipas transaksionit të datës 1.7.2010, Alpha Bank, pagesa nga dëmshpërblimi, vendimi gjyqësor nr. ***, datë 22.5.2009, debitor ATSH; (ii) shumën 64,000 lekë, transaksion datë 4.10.2011; (iii) shuma 600,000 lekë rezulton e tërhequr në datën 16.11.2011 nga Alpha Bank (mbyllje llogarie pranë Alfa Bank, datë 16.11.2011, me vlerë 500,000 lekë, plus 100,000 lekë nga të ardhurat e punësimit, llogari rrjedhëse); (iv) të ardhurat nga paga gjatë punës në ATSH (krijuar deri në vitin 2007) dhe AKSHI”.

17.17 Subjekti ka deklaruar se ka përdorur edhe një pjesë nga paratë e përfituara nga shitja e apartamentit të prindërve në Gjirokastër, por pa e saktësuar atë. Më tej, ajo²⁹ ka deklaruar se nga kjo shumë nuk ka shpenzuar për blerjen e pasurisë objekt hetimi, por nga ajo ka përdorur një pjesë për përmbushjen e kushteve funksionale të apartamentit dhe bërjes së tij të banueshëm (vlera 198,600 lekë, përdorur për mobilim dhe elektroshtëpiake)³⁰. Gjithashtu, subjekti ka pranuar se në periudhën kur ka bërë deklarinimin në deklaratën *Vetting* duhej të ishte më korrekte në mënyrën e të shprehurit.

17.18 Komisioni kreu analizën financiare për të parë mundësitë financiare të subjektit të rivlerësimit në kryerjen e pagesave të kësaj pasurie sipas dokumentacionit të administruar.

17.18.1 Për pagesën e parë prej 200,000 lekësh në datën 8.6.2012, Komisioni kreu analizën financiare për periudhën 2005 – 2011. Analiza është nisur prej vitit 2005, pasi për vitet 2003 – 2004 subjekti ka qenë deklarues në ILDKPKI për shkak të pozicionit që ka pasur në ato vite dhe nuk rezulton të ketë deklaruar kursime *cash*.

Tabela nr. 2

Nr.	Përshkrimi	2005 – 2011
1	TË ARDHURA	7,019,601
	Të ardhura nga paga subjekti	7,019,601
2	SHPENZIME	1,680,639
	Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	902,214
	Shpenzime qiraje	519,600
	Shpenzime TIMS	258,825
3	PASURI	51,526
	Pasuri e paluajtshme/e luajtshme	
	<i>Ndryshim likuiditeti</i>	51,526
	DIFERENCA (1-2-3)	5,287,436

²⁸ Me shkresën nr. ***, datë 27.2.2024, administruar në dosjen e Komisionit.

²⁹ Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, datë 30.4.2024, administruar në dosjen e Komisionit.

³⁰ Dokumentacion shpjegues për arredimin dhe blerjet e elektroshtëpiakeve, depozituar në përgjigje të pyetësorit nr. 2, datë 30.4.2024, administruar në dosjen e Komisionit.

17.18.1.i Nga përlllogaritjet e kryera përmes Njesisë së Shërbimit Ligjor, Komisioni konstatoi se subjekti ka pasur mundësi financiare të kursejë, pasi në fund të vitit 2011 rezultoi me balancë pozitive në vlerën 5,287,436 lekë, shumë kjo e mjaftueshme për të paguar këstin në shumën 200,000 lekë, në datën 8.6.2012.

17.18.2 Lidhur me pagesën e kryer në datën 10.7.2012, në shumën 717,400 lekë. Komisionit, referuar fakteve të dala për këtë çështje parashtruar më sipër në këtë vendim, i rezultoi se kjo shumë është marrë hua nga shoqëria me administrator shtetasin A.Ç, ku nga hetimi rezultoi se ky shtetas ka pasur mundësi financiare për dhënien e kësaj huaje subjektit të rivlerësimit.

17.18.3 Lidhur me pagesën e kryer në datën 13.9.2012, në shumën 2,800,000 lekë, e cila është transaksion bankar me burim krijimi kredinë e marrë në BKT. Për këtë kredi, Komisioni ka analizuar nëse subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi për të plotësuar shumën e vendosur kolateral për marrjen e kredisë. Nga shuma totale prej 3,133,000 lekësh e bllokuar, subjekti i rivlerësimit ka kontribuar në vlerën 915,600 lekë, pasi pjesa tjetër është marrë hua nga shoqëria. Në analizën e kryer, pasqyruar në tabelën e mëposhtme, është përfshirë bashkëshorti i subjektit nga muaji dhjetor 2012, pasi në këtë muaj ka nisur bashkëjetesa.

Tabela nr. 3

Nr.	Përshkrimi	2012
1	TË ARDHURA	11,458,109
	Të ardhura nga paga subjekti	1,024,495
	Të ardhura nga paga bashkëshorti	81,178
	Të ardhura nga kredia	2,847,600
	Të ardhura nga huaja	2,217,400
	Të ardhura nga periudha e mëparshme	5,287,436
2	SHPENZIME	385,226
	Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	152,776
	Shpenzime qiraje	73,700
	Shpenzime TIMS	76,846
	Detyrim ushqimor ndaj fëmijës K.M	10,000
	Shpenzime kredia (principal + interes) në BKT (subjekti)	47,572
	Shpenzime kredia (principal + interes) në Credins (bashkëshorti)	24,332
3	PASURI	6,099,731
	Pasuri e paluajtshme/e luajtshme	
	Apartament me sip. 66 m ² (56.7 m ² + 9.3m ²), K, Tiranë (9.6.2012)	3,000,000
	<i>Ndryshim likuiditeti</i>	3,099,731
	DIFERENCA (1-2-3)	4,973,152

17.18.3.i Nga përlllogaritjet e kryera përmes Njesisë së Shërbimit Ligjor, Komisioni konstatoi se subjekti ka pasur mundësi financiare të plotësojë barrën siguroese, si dhe të përballojë shpenzimet e tjera familjare.

1.18.4 Lidhur me pagesën e kryer në datën 14.8.2015, në shumën 3,009,500 lekë, rezultoi se kjo shumë përfshin shlyerjen e huas ndaj shoqërisë në vlerën 2,217,400 lekë, këstin e fundit prej 778,600 lekësh, si dhe diferencën prej 13,500 lekësh, të paguar për kontratën e UKT-së.

17.18.5 Shuma totale e paguar sipas dokumentacionit është 4,496,000 lekë, ndërsa vlera e pasurisë sipas kontratës së porosisë/shitjes është 4,587,000 lekë. Subjekti ka sqaruar dhe dokumentuar se kjo diferencë prej 91,000 lekësh është për shkak të zbritjes së kostos së pllakave, e cila nuk është realizuar nga ndërtuesi.

17.18.6 Komisioni kreu analizën financiare për pagesat e kryera dhe rezultoi si më poshtë, pasqyruar në tabelën nr. 3.

Tabela nr. 4

Nr.	Përshkrimi	2015
1	TË ARDHURA	9,143,201
	Të ardhura nga paga subjekti	803,183
	Të ardhura nga paga bashkëshorti	1,499,040
	Të ardhura nga interesat	19,918
	Të ardhura nga periudha e mëparshme	6,821,060
2	SHPENZIME	3,343,801
	Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	448,552
	Shpenzime TIMS	34,413
	Detyrim ushqimor ndaj fëmijës K.M	120,000
	Shpenzime shkollimi për djalin K.M	80,000
	Shpenzime kredia (principal + interes) në BKT (subjekti)	190,287
	Shpenzime kredia (principal + interes) në Credins (bashkëshorti)	98,150
	Shpenzime arredimi	155,000
	Të ardhura nga huaja	2,217,400
3	PASURI	(2,393,208)
	Pasuri e paluajtshme/e luajtshme	
	Apartament me sip. 66 m ² (56.7 m ² + 9.3 m ²), K, Tiranë (9.6.2012)	778,600
	<i>Ndryshim likuiditeti</i>	(3,171,808)
	DIFERENCA (1-2-3)	8,192,609

17.18.7 Komisionit përgjatë hetimit për këtë pasuri i rezultoi se: (i) subjekti ka pasur mundësi të shlyejë këstet e kësaj pasurie, si dhe të përballojë shpenzimet e tjera familjare; (ii) duke se subjekti ka kryer deklaram të pasaktë lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie, pasi në deklaratën *Vetting* ka deklaruar si burim krijimi edhe të ardhura nga shitja e pasurisë së prindërve të saj në Gjirokastër, ndërkohë që gjatë hetimit ka deklaruar se kanë shërbyer të ardhurat nga punësimi i saj, për pasojë i kërkoi shpjegime lidhur me këtë konstatim.

17.18.8 Në qëndrimin e saj, subjekti ka parashtruar deklaramet për burimet e krijimit të kësaj pasurie në deklaratën *Vetting*, në pyetësin nr. 2, duke sqaruar se sikurse ka shpjeguar në këtë pyetësor në kohën kur është hartuar deklarata *Vetting*, nuk ka pasur rubrika të posaçme, ku të pasqyrohen shpenzimet e tjera të kryera për banesën (mobilim + elektroshtëpiake), dhe duke mos pasur informacion në lidhje me pyetësorët në vijim, në atë kohë ka menduar se do ishte më korrekte të shprehej në atë mënyrë. Sipas subjektit, koncepti i apartamentit të banimit nuk ka të bëjë vetëm me blerjen e objektit, por njëkohësisht dhe me investimet/shpenzimet e tjera shtesë që kryhen nga blerësi për ta bërë atë funksional dhe të banueshëm dhe, për këtë shkak, ajo ka menduar të përfshijë në burimin e kësaj pasurie edhe të ardhurat nga babai, që sikurse ka deklaruar në pyetësin nr. 2 ato janë përdorur vetëm për plotësimin e nevojave shtesë të objektit dhe kthimin e saj në një ambient të përshtatshëm banimi.

17.18.9 Në përfundim, subjekti ka kërkuar që kjo pasaktësi të vlerësohet si një pasaktësi në të shprehur, pa pasur ndonjë qëllim për fshehje pasurie apo deklaram të rremë, në kushtet kur pasuria rezulton plotësisht e krijuar nga burime të ligjshme.

17.18.10 Trupi gjykues, në analizë të fakteve të rezultuara përgjatë hetimit administrativ, shpjegimeve të dhëna nga subjekti lidhur me këtë çështje, vlerëson se argumentet e saj për mungesë rubrike apo çështje konceptuale nuk janë të pranueshme, pasi në këtë drejtim evidentohet fakti se Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, në zbatim të nenit D të ligjit nr. 79/2016, dhe neneve 30, 31, 32 dhe 33 të ligjit nr. 84/2016, datë 30.8.2016, me udhëzimin nr. 4095 prot., datë 10.10.2016, ka përcaktuar qartë rregullat dhe mënyrën e plotësimit të deklaratës së pasurisë, si dhe dokumenteve që justifikojnë vërtetësinë e deklaramit dhe ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive. Trupi gjykues në këtë çështje objekt vlerësimi çmon se subjekti ka kryer deklaram të pasaktë lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie.

17.18.11 Në përfundim, trupi gjykues, duke iu referuar fakteve tërësore të dala gjatë hetimit, ku në këtë rast nuk është cenuar ligjshmëria e burimeve, pasi nga hetimi arrihet të identifikohen veprimet e kryera si për burimet e krijimit të pasurisë, ashtu edhe për shpenzimet e kryera, si dhe në mungesë të ndonjë rrethane për të fshehur një qëllim të caktuar, konkludon se kjo pasaktësi proporcionalisht nuk përbën shkak të mjaftueshëm për penalizimin e subjektit.

18. Pasuri e luajtshme, automjeti tip “Opel Astra”, nr. shasie ***, sipas certifikatës së pronësisë së automjetit, të lëshuar në datën 6.5.2014. Shitblerja është kryer sipas të dhënave të kontratës noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 5.4.2014, nga kursimet nga pagat (të ardhurat personale). Vlera: 4,400 euro. Pjesa takuese: 50%. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente³¹.

18.1 ILDKPKI-ja në raportin e saj është shprehur: *Përputhet deklarami i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e ardhur nga DPSHTRR-ja.*

Hetimi i Komisionit

18.2 Nga hetimi i Komisionit rezultoi se subjekti e ka deklaruar për herë të parë automjetin tip “Opel Astra”, me targë ***, nr. shasie ***, në deklaratën e pasurisë *Vetting*.

18.3 Subjekti ka depozituar kontratë shitblerjeje automjeti nr. *** rep., nr. *** kol, datë 5.4.2014, nga ku rezulton se automjeti është blerë në bashkëpronësi nga subjekti dhe bashkëshorti i saj në vitin 2014. Në kontratë cilësohet se çmimi i shitjes është 4,400 euro.

18.4 DPSHTRR-ja³² nuk informon për mjete në pronësi të subjektit të rivlerësimit, por informon se shtetasi N.S.M (bashkëshorti i subjektit) ka pasur të regjistruar automjetin me targë *** (***) . Në dokumentacionin e depozituar rezulton blerja e automjetit tip “Opel Astra”, me targë ***, nëpërmjet kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 5.4.2014, me palë shitëse V.L dhe

³¹ Certifikatë pronësie mjeti me targë ***, datë 6.5.2014, në emër të shtetasve N.M dhe Majlinda Moshë. Kontratë shitblerjeje automjeti nr. *** rep., nr. *** kol., datë 5.4.2014, për blerje mjeti me targë ***. Vlera: 4,400 euro. Palë shitëse V.L dhe palë blerëse Majlinda Moshë e N.M, certifikata e pronësisë së mjetit ***, datë 21.8.2012, si dhe leje qarkullimi mjeti me targë ***, datë 21.8.2010 (aneks nr. 4/3, administruar në dosjen e ILDKPKI-së).

³² Me shkresën nr. *** prot., datë 30.7.2021.

palë blerëse Majlinda Mosho dhe N.M në vlerën 4,400 euro. Ky mjet, pas depozitimit të deklaratës *Vetting*, është shitur³³ dhe nuk është më në pronësi të bashkëshortëve.

18.5 Subjekti ka deklaruar burim krijimi për këtë pasuri kursimet nga pagat (të ardhurat personale).

18.6 Komisioni kreu analizën financiare dhe rezultoi se subjekti i rivlerësimit e ka mbyllur vitin 2013 me balancë në shumën 7,006,085 lekë. Kjo shumë është më se e mjaftueshme për të mbuluar investimin e kryer në muajin prill 2014.

18.6.1 Komisioni kreu edhe analizën vjetore për vitin 2014 dhe nuk i rezultuan problematika.

19. Llogari rrjedhëse pranë Alpha Bank me nr. ***, gjendja e llogarisë në datën 24.1.2017, në vlerën 160,295.39 lekë. Burimi i krijimit: të ardhurat personale/pagat. Pjesa takuese: 100%. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës nxjerrje llogarie të Alpha Bank, e datës 10.1.2017, me gjendje 160,295.39 lekë + pozicioni i klientit.

19.1 ILDKPKI-ja në raportin e saj është shprehur: *Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e ardhur nga Alpha Bank.*

19.2 OTP Bank³⁴ informon se znj. Majlinda Miska ka pasur llogari bankare pranë kësaj banke (ish-Alpha Bank, pasi është përthithur nga OTP Bank), e cila është mbyllur. Nga hetimi rezulton se kjo llogari është çelur në datën 5.5.2010 dhe është mbyllur në datën 22.12.2021. Në këtë llogari subjektit i është kredituar paga. Gjendja e llogarisë në datën 27.1.2017 kur është depozituar deklarata *Vetting* është 160,295.47 lekë. Konstatohet se përputhet deklarimi i subjektit me përgjigjen e ardhur nga OTP Bank (ish-Alpha Bank).

20. Llogari rrjedhëse pranë BKT-së. Burimi i krijimit i deklaruar nga subjekti i rivlerësimit: Pagesat e përfituara në formën e dëmshpërblimit për largim të padrejtë nga puna në ATSH, në vlerën 941,045 lekë. Pjesërisht nga kursimet e të ardhurave të subjektit dhe bashkëshortit të saj. Bashkëngjitur Vërtetim i datës 24.1.2017. Vlera 18,192.80 euro. Pjesa takuese: 50%. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente³⁵.

20.1 ILDKPKI-ja në raportin e saj është shprehur: *Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ardhur nga BKT dhe DPPPP.*

20.2 BKT-ja³⁶ informon se znj. Majlinda Miska ka llogari bankare në monedhën euro pranë BKT-së. Nga hetimi rezulton se kjo llogari është hapur në datën 1.12.2015. Brenda periudhës së rivlerësimit rezultojnë se janë kryer transaksionet e mëposhtme:

- Në datën 1.12.2015 është depozituar nga subjekti i rivlerësimit *cash* shuma 10,230 euro;
- Në datën 14.6.2016 është depozituar nga subjekti i rivlerësimit *cash* shuma 7,980 euro.

20.3 DPPPP-ja³⁷ konfirmon se znj. Majlinda Miska ka raportime financiare vetëm me mbiemrin e vajzërisë Majlinda Mosho dhe ka raportuar si vijon:

³³ Kontratë shitblerjeje automjeti nr. *** rep., nr. *** kol., datë 24.4.2017, vlera 3,700 euro, palë shitëse Majlinda Miska (Mosho) e N.M dhe palë blerëse A.S.

³⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 17.5.2024.

³⁵ Vërtetim nr. *** prot., datë 24.1.2017, lëshuar nga BKT, e cila konfirmon se Majlinda Mosho ka llogari me gjendje në datën 24.1.2017 në vlerën 18,192.80 euro, si dhe nxjerrje e llogarisë në euro për periudhën datë 1.12.2015 – 28.12.2016. Në datën 1.12.2015 ka derdhur *cash* 10,230 euro dhe në datën 14.6.2016 ka derdhur *cash* 7,980 euro dhe balanca në datën 28.12.2016 është 18,192.80 euro (aneks nr. 4/4 dhe 4/5, në dosjen e ILDKPKI-së).

³⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 5.8.2021.

³⁷ Me shkresën nr. *** prot., datë 10.5.2017 (aneks nr. 34 në dosjen e ILDKPKI-së).

Tabela nr. 5

Data	Banka	Nr. llogarie	Vleftha	Përshkrimi
1.12.2015	BKT	***	10.230 euro	Majlinda P. Mosho derdhje në llogari. Burim i të ardhurave: kursime, konvertuar nga depozita e mëparshme ALL.
14.6.2016	BKT	***	7.980 euro	Majlinda Mosho derdh në llogari

20.4 Komisioni e ka pyetur³⁸ subjektin për burimin e krijimit të shumave të depozituara dhe, në përgjigje, në lidhje me shumën 10,230 euro, depozituar në BKT në datën 1.12.2015, subjekti ka deklaruar: Në datën 11.11.2015 kam kryer veprime pranë llogarisë rrjedhëse të Bankës Kombëtare Tregtare duke tërhequr cash vlerën 1,200,000 lekë, me përshkrimin “Për të blerë valutë...”. Këtë shumë unë e kam konvertuar në valutë, në vlerën 10,230 euro. Është pikërisht kjo shumë që është depozituar nga unë në llogarinë në euro, në datën 1.12.2015. Shuma 1,200,000 lekë ka si burim të ardhurash transaksionin e datës 26.12.2014, sipas së cilës është kaluar shuma 4,000,000 lekë nëpërmjet bankës BKT. Në lidhje me shumën 7,980 euro, depozituar në BKT në datën 14.6.2016, deklaroj se kjo shumë ka si burim të ardhurash: i) Shumën 357,982 lekë që ka burim shpërblimin/bonusin e përfituar nga punësimi i bashkëshortit tim pranë kompanisë “V Albania”, pagesë e kryer në datën 29.6.2015 pranë Alpha Bank. ii) Diferenca e depozituar për këtë shumë ka si burim pagesat e përfituara në formën e dëmshpërblimit për largim të padrejtë nga puna, ATSH:

- transaksioni datë 21.5.2013 – vlera 200,000 lekë;
- transaksioni datë 6.8.2013 – vlera 300,000 lekë;
- transaksioni datë 26.9.2013 – vlera 100,000 lekë”.

20.5 Komisioni pasi verifikoi të gjitha transaksionet e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit konstatoi se ato konfirmohen. Lidhur me të ardhurat nga shitja e pasurisë së prindërve, ato janë analizuar më sipër në këto rezultate. Ndërsa për sa i përket të ardhurave nga punësimi, Komisioni kreu analizën financiare për të parë mundësinë e kursimit dhe investimit të tyre dhe në tërësi nuk i rezultuan problematika.

20.6 Gjendja e llogarisë në datën 27.1.2017, kur është depozituar deklarata *Vetting*, rezultoi 18,191.3 euro lekë. Komisioni konstatoi se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e administruar nga BKT-ja.

21. Llogari rrjedhëse pranë BKT-së. Burimi i krijimit: pagesat e përfituara në formën e dëmshpërblimit për largim të padrejtë nga puna, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit. Bashkëngjitur vërtetim i datës 24.1.2017. **Vlera: 1,450,709 lekë.** Pjesa takuese: 100%. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës³⁹ vërtetimin nr. *** prot., datë 24.1.2017, lëshuar nga BKT-ja, ku citohet se Majlinda Mosho ka llogari me gjendje në datën 24.1.2017 vlerën 1,450,709 lekë.

21.1 ILDKPKI-ja në raportin e saj është shprehur: *Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar, si dhe me përgjigjet e BKT-së dhe DPPP.*

³⁸ Pyetësor nr. 3, datë 16.5.2024.

³⁹ Aneks nr. 4/5 në dosjen e ILDKPKI-së.

21.2 BKT-ja⁴⁰ informon se znj. Majlinda Miska ka llogari bankare pranë kësaj banke. Nga hetimi rezulton se në këtë llogari subjektit të rivlerësimit i kreditohet paga. Gjithashtu, në këtë llogari i është disbursuar kredia për blerjen e apartamentit. Gjendja e llogarisë në datën 27.1.2017, kur është depozituar deklarata *Vetting*, është 1,450,709.85 lekë. Kjo shumë vjen kryesisht si rezultat i ekzekutimit të vendimit nr. ***, datë 5.6.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë⁴¹, ku në datën 11.1.2017 është transferuar shuma 1,321,291 lekë. Komisioni konstatoi se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e administruar nga BKT-ja.

22. Gjendje cash. Nga të ardhurat personale të subjektit, të ardhurat personale të bashkëshortit, si dhe bonuset e përfituara nga puna që kryen. **Vlera: 1,350,000 lekë.** Pjesa takuese: 50%.

22.1 ILDKPKI-ja në raportin e saj është shprehur: *Subjekti ka deklaruar të ardhura të mjaftueshme për të krijuar gjendjen cash të deklaruar.*

22.2 Nisur nga fakti se subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë subjekt deklarues, Komisioni ka kryer analizën financiare për periudhën 2005 – 2016, duke përfshirë të ardhurat dhe shpenzimet e identifikuara, për të parë mundësitë financiare të subjektit. Për periudhën dhjetor 2012 – 2016 janë përfshirë edhe të ardhurat/shpenzimet e bashkëshortit, pasi subjekti ka deklaruar⁴² se në dhjetor 2012 ka nisur të bashkëjetojë me shtetasin N.M. Ky i fundit prej muajit korrik të vitit 2014 është bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit.

22.3 Gjithashtu, në përgjigje të pyetëtorit nr. 3, subjekti ka sqaruar se nga shuma prej 2,200,000 lekësh, me burim nga shitja e pasurisë së prindërve në qytetin e Gjirokastrës, të tërhequr nga llogaria bankare në BKT, në datën 26.12.2014, është ruajtur shuma 1,071,400 lekë si pjesë përbërëse e kursimit të deklaruar gjendje *cash* në deklaratën *Vetting* prej 1,350,000 lekësh.

- Komisioni kreu analizën financiare si më poshtë pasqyruar:

Tabela nr. 6

Nr.	Përshkrimi	2016
1	TË ARDHURA	10,766,110
	Të ardhura nga paga subjekti	1,055,962
	Të ardhura nga paga bashkëshorti	1,517,539
	Të ardhura nga periudha e mëparshme	8,192,609
2	SHPENZIME	821,052
	Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	470,184
	Shpenzime TIMS	40,581
	Detyrim ushqimor ndaj fëmijës K.M	120,000
	Shpenzime kredia (principal + interes) në BKT (subjekti)	190,287
3	PASURI	1,329,361
	Pasuri e paluajtshme/e luajtshme	
	<i>Ndryshim likuiditeti</i>	1,329,361
	DIFERENCA (1-2-3)	8,615,697

⁴⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 5.8.2021, administruar në dosjen e Komisionit.

⁴¹ Vendim nr. ***, datë 5.6.2014, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, lënë në fuqi me vendimin nr. ***, datë 16.12.2015, nga Gjykata Administrative e Apelit.

⁴² Pyetësor nr. 3, datë 16.5.2024, administruar në dosjen e Komisionit.

22.4 Nga përlllogaritjet e kryera përmes Njësisë së Shërbimit Ligjor, Komisioni konstatoi se subjekti ka pasur mundësi financiare të kursejë shumën 1,350,000 lekë, si dhe të përballojë shpenzimet e tjera familjare.

DETYRIME FINANCIARE

23. Kredi bankare, sipas të dhënave të kontratës noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.9.2012, me kredidhënës BKT, dega “****”, Tiranë. Totali i kredisë në shumën 2,847,600 lekë. **Detyrimi i mbetur 2,369,061.54 lekë**. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente⁴³.

23.1 ILDKPKI-ja në raportin e saj është shprehur se:

- Subjekti ka deklaruar se për përfitimin e kredisë preferenciale ka vendosur kolateral depozitën në BKT, në shumën 3,133,000 lekë, kolateral i cili nuk ekziston më, pasi si kolateral është vendosur apartamenti i blerë pjesërisht me këtë kredi.

- Sipas nxjerrjes së llogarisë në BKT, rezulton se subjekti në datën 14.8.2015 ka kryer transaksionin me përshkrimin “Shuma 3,009,500 lekë ka kaluar për “****” sh.p.k. me përshkrimin “Likuidim detyrimi sipas aktit të nënshkruar midis “****”, për detyrimin 2,996,000 lekë, për kontratën e shitblerjes së apartamentit”.

- Është i paqartë transaksioni i mësipërm, pasi subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën *Vetting* të ketë pasur marrëdhënie juridike me shoqërinë “***” sh.p.k., gjithashtu edhe burimi financiar që ka shërbyer për hapjen e depozitës, e cila është vendosur si kolateral për marrjen e kredisë.

Hetimi i Komisionit

23.2 Komisioni, lidhur me kredinë e marrë në BKT, në vitin 2012, qëllimin e marrjes së saj, destinacionin, transaksionet e kryera me shoqëritë “****” sh.p.k. dhe “****” sh.p.k., etj., ka parashtruar faktet e konkluduara më sipër në këtë vendim, trajtuar në pasurinë nr. 1 të deklaruar nga subjekti.

23.3 Komisioni konstatoi se vlera e mbetur e kredisë deri më 27.1.2017, kur është depozituar deklarata *Vetting*, është në shumën 2,369,061.54 lekë. Rezultoi se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e administruar nga BKT-ja.

24. Subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting* një hua të marrë nga personi i lidhur/bashkëshorti sipas të dhënave të kontratës noteriale në vlerën 27,000 euro, për shlyerje detyrimi, me detyrim të mbetur 20,000 euro. Subjekti për marrjen e shumës 27,000 euro pa interes, i ka bashkëlidhur deklaratës⁴⁴ kontratën e huas nr. *** rep., nr. *** kol., datë 6.12.2011, me palë huadhënëse S.M dhe huamarrëse N.M.

24.1 ILDKPKI-ja në raportin e saj është shprehur: *Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor lidhur me mundësinë financiare të shtetasit S.M, për huan e dhënë në shumën 27,000 euro*

⁴³ Kontratë kredie nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.9.2012, me kredidhënës BKT e kredimarrës Majlinda Mosho, në shumën totale 2,847,600 lekë. Vërtetim nr. *** prot, datë 24.1.2017, lëshuar nga BKT-ja për kredinë e marrë nga Majlinda Mosho në shumën 2,847,600 lekë, me këst mujor 15,857.27 lekë. Vlera e mbetur e kredisë 2,369,061.54 lekë. Nxjerrje llogarie në lekë në BKT. Në datën 13.9.2012 është disbursuar kredia në shumën 2,847,600 lekë dhe në datën 13.9.2012, shuma 2.800.000 lekë ka kaluar në llogari të shoqërisë “****” për blerje apartamenti pagesë kësti i dytë. Në datën 3.9.2012 ka derdhur *cash* 2,500,000 lekë dhe në datën 4.9.2012 shuma 3,133,000 lekë kalon në depozitë 200-ditore. Në datën 26.12.2014 transferohet shuma 4,000,000 lekë (kjo shumë ka kaluar nga llogaria e babait me burim nga shitja e shtëpisë veprim i cili është sqaruar më sipër). Në datën 29.12.2014 ka tërhequr *cash* nga llogaria 2,200,000 lekë. Në datën 14.8.2015, shuma 3,009,500 lekë ka kaluar për shoqërinë “****” sh.p.k., me përshkrimin “Likuidim detyrimi sipas aktit të nënshkruar midis *** për detyrimin 2,996,000 lekë për kontratën e shitblerjes së apartamentit” (aneks nr. 4/7 në dosjen e ILDKPKI-së).

⁴⁴ Aneks nr. 4/8 në dosjen e ILDKPKI-së.

bashkëshortit të subjektit, pasi ISSH-ja konfirmon se ky shtetas nga prilli 2000 përfiton pension pleqërie në shumën 16,452 lekë.

Hetimi i Komisionit

24.2 Nga hetimi i kryer rezultoi se subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting* se huaja i është marrë vjehrrit të saj, z. S.M, sipas kontratës noteriale nr. ***, datë 6.12.2011.

24.3 DPPPP-ja⁴⁵ konfirmon se për shtetasin N.M ka raportime të kontratave noteriale. Informacioni konfirmon se në datën 6.12.2011 z. M ka marrë hua në shumën 27,000 euro nga shtetasi S.M, i datëlindjes 1.5.1940.

24.4 Nga verifikimi i kontratës së huas konstatohet se ajo është hartuar konform ligjit. Në të janë përcaktuar palët kontraktore dhe, më konkretisht, huadhënës S.M dhe huamarrës N.M, është pasqyruar shuma e dhënë hua, 27,000 euro pa interes, si dhe është saktësuar edhe koha e likuidimit të saj. Për këtë të fundit kontrata ka parashikuar se likuidimi do të fillojë në datën 15.10.2012, me këst mujor 20,000 lekë, deri në shlyerjen përfundimtare të shumës.

24.5 Rezulton se bashkëshorti i subjektit ka deklaruar tek rubrika “Detyrimet financiare” se detyrimi i mbetur i huas është 20,000 euro.

24.6 Referuar marrëveshjes datë 8.12.2011⁴⁶ (kohë kur bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ishte në një martesë tjetër), nënshkruar midis bashkëshortit të subjektit dhe ish-bashkëshortes së këtij të fundit, e cila është miratuar me vendimin nr. ***, datë 5.4.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me objekt “Zgjidhje martese”, konfirmohet marrja e kësaj huaje me qëllim shlyerjen e ish-bashkëshortes për pjesën e saj takuese në apartamentin e deklaruar nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit në deklaratën *Vetting* (i trajtuar në vijim tek deklarimi i pasurive të bashkëshortit të subjektit) dhe, më tej konfirmohet edhe përfitimi i apartamentit nga bashkëshorti i subjektit, si titullar i vetëm i tij.

24.7 Komisioni, duke konstatuar faktet se: (i) pasuria e trajtuar tek deklarimi i pasurive të bashkëshortit të subjektit ka si titullar të vetëm bashkëshortin e subjektit të rivlerësimit; (ii) kjo hua ka shërbyer për të përfunduar një marrëdhënie midis bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit dhe ish-bashkëshortes së këtij të fundit; (iii) ka zgjidhur një regjim tjetër martesor pa lidhje me subjektin e rivlerësimit; (iv) është lëvruar 3 vite para martesës së subjektit të rivlerësimit me bashkëshortin e saj dhe, po ashtu, 4 vite përpara se subjekti të niste detyrën si subjekt i këtij ligji; (v) nuk rezultoi asnjë e dhënë që lidh subjektin e rivlerësimit me bashkëshortin e saj përgjatë periudhës së dhënies së huasë, nënshkrimit të marrëveshjes datë 8.12.2011 dhe deri në bashkëjetesë; (vi) subjekti i rivlerësimit nuk ka të drejtë pronësore, përveçse përdorimin e banesës për të cilën u përdor huaja – çmoi se në këtë çështje objekt vlerësimi nuk ka rrethana që impaktojnë pozitën e subjektit apo bashkëshortit të saj për efekt të procesit të rivlerësimit.

25. Subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting* se bashkëshorti i saj paguan detyrime familjare, në shumën fikse 10,000 lekë.

25.1 ILDKPKI-ja në raportin e saj është shprehur: *Nga informacioni i DPPPP-së rezulton marrëveshja për zgjidhje martese.*

Hetimi i Komisionit

⁴⁵ Me shkresën nr. *** prot., datë 27.4.2017.

⁴⁶ Konfirmuar edhe nga DPPPP-ja me shkresën nr. *** prot., datë 27.4.2017, administruar në dosjen e ILDKPKI-së.

25.2 Subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting* se bashkëshorti paguan detyrime ushqimore ndaj fëmijës së tij në shumën fikse 10,000 lekë, për një kohë të pacaktuar, sipas vendimit nr. ***, datë 5.4.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Sipas këtij vendimi rezulton se gjykata ka vendosur këtë masë si detyrim pensioni ushqimor nga z. M për fëmijën e tij, si rezultat i zgjidhjes së martesës me ish-bashkëshorten dhe lënien e fëmijës për rritje e edukim kësaj të fundit.

25.3 DPPPP-ja⁴⁷ konfirmon se shtetasi N.M në datën 8.12.2011 ka lidhur një marrëveshje për zgjidhje martese, ku shtetasja E.M (bashkëshortja e tij) ka hequr dorë nga pasuria e përbashkët me shtetasin N.M kundrejt shumës 27,000 euro.

25.4 Komisioni e ka përfshirë detyrimin familjar tek shpenzimet dhe nga analiza financiare e kryer nuk i kanë rezultuar problematika.

DEKLARIMI I PASURIVE TË BASHKËSHORTIT TË SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

26. Apartament banimi me sipërfaqe totale 125 m², sipas të dhënave të kontratës noteriale “Për kalim të drejtash” nr. *** rep., nr. *** kol. Burimi i krijimit: shitja e shtëpisë së mëparshme sipas kontratës së shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., ku shitja e apartamentit është kryer në vlerën 62,000 euro; kursimet sipas të ardhurave. Vlera: 67,500 euro. Pjesa takuese 100%. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente⁴⁸.

26.1 ILDKPKI-ja në raportin e saj është shprehur: *Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar, si dhe me përgjigjen e ardhur nga DPPPP-ja dhe nga ZVRPP Tiranë. Nuk është nënshkruar ende kontrata përfundimtare e shitblerjes.*

Hetimi i Komisionit

26.2 ZQRPP-ja⁴⁹ ka bashkëlidhur përgjigjen e ZVRPP Tiranë, nr. *** prot., datë 13.11.2017, ku konfirmohet se në emër të shtetasit N.M nuk figurojnë e regjistruar pasuri e paluajtshme.

26.3 Komisionit, nga verifikimi i dokumentacionit të depozituar, i rezultoi se apartamenti është blerë nga bashkëshorti i subjektit dhe ish-bashkëshortja e tij në vitin 2010. Fillimisht, nga kontrata e shitjes⁵⁰ për apartamentin 1+1, rezulton se bashkëshorti i subjektit në vitin 2001 ka blerë apartamentin 1+1 në vlerën 22,225 USD, të cilin me dakordësinë e ish-bashkëshortes e ka shitur në vitin 2009 në vlerën 62,000 euro. Vlera e shitjes është likuiduar në prani të noteres nga pala blerëse, e cila ka paguar 58,000 euro, minus 4,000 euro që është 10% e detyrimit tatimor mbi shitjen. Me kontratën e kalimit⁵¹ të të drejtave midis palës blerëse dy ish-bashkëshortëve M dhe palës shitëse B.B kanë kaluar të drejtat mbi apartamentin sipas kontratës

⁴⁷ Me shkresën nr. *** prot., datë 27.4.2017, administruar në dosjen e ILDKPKI-së (aneks nr. 34).

⁴⁸ Kontratë kalimi të drejtash nr. *** rep., nr. *** kol., datë 3.3.2010, me objekt apartamentin me sip. 125 m², me vlerë 67,500 euro. Palë e parë – B.B (posedues); palë e dytë – N.M (përfituesi) dhe palë e tretë shoqëria “****” sh.p.k. (me cilësinë e marrjes në dijeni). Vlera e blerjes së apartamentit u likuidua totalisht *cash* në prani të noteres. Kontratë porosie nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.10.2008, me palë sipërmarrës shoqëria “****” sh.p.k. dhe porositës B.B, me vlerë 62,500 euro. Mandatpagesat në shumën totale 60,000 euro, paguar nga porositësi B.B te sipërmarrësi për blerje shtëpie me sip. 125 m². Kontratë paraprake shitjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.11.2009, me palë shitëse N.M dhe palë blerëse L.L.L., me çmim shitjeje 62,000 euro të apartamentit nr. *** (meqenëse gjithë godina në proces legalizimi), si dhe bashkëlidhur deklarata noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.11.2009 (aneks nr. 4/9, administruar në dosjen e ILDKPKI-së).

⁴⁹ Me shkresën nr. *** prot., datë 16.11.2017 (aneks nr. 28, administruar në dosjen e ILDKPKI-së).

⁵⁰ Nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.11.2009, administruar në aneksin nr. 4/9, në dosjen e ILDKPKI-së.

⁵¹ Nr. *** rep., nr. *** kol., datë 3.3.2010, lidhur midis dy ish-bashkëshortëve E. dhe N.M dhe palës shitëse shtetasit B.B (aneks nr. 4/9, administruar në dosjen e ILDKPKI-së).

së porosisë⁵² nga pala shitëse B.B tek pala blerëse E dhe N.M. Në nenin 3 të kontratës së kalimit të të drejtave specifikohet se apartamenti është blerë në vlerën 67,500 euro, minus 500 euro që është 10% e detyrimit tatimor mbi shitjen. Vlera e blerjes së apartamentit sipas kësaj kontrate është likuiduar totalisht *cash* para noterit. Bashkëshorti i subjektit ka deklaruar se apartamenti me sip. 125 m² është 100% në pronësi të tij.

26.4 Nga hetimi i Komisionit rezultoi se sipas marrëveshjes noteriale⁵³ të vitit 2011 “Mbi zgjidhjen e martesës dhe rregullimit të marrëdhënieve pasurore të përbashkëta”, të nënshkruar midis shtetasve N.M dhe E.M, dhe të miratuar me vendimin e gjykatës⁵⁴ të vitit 2012, palët kanë rënë dakord, ndër të tjera, që të mos jenë bashkëpronarë të apartamentit në rrugën “****”, me sip. 125 m². Ato janë dakortësuar që apartamenti do të jetë në pronësi të shtetasit N.M, i cili duhet t’i paguajë ish-bashkëshortes E.M vlerën monetare 27,000 euro, ku përfshihet kontributi i dhënë prej saj si për apartamentin, edhe për arredimin e tij.

26.5 Subjekti i rivlerësimit ka depozituar certifikatën e regjistrimit të pasurisë datë 4.2.2021, marrë nga portali *e-Albania* për apartamentin me sip. 125 m², me vendndodhje: zona kadastrale nr. 8330, lloji i pasurisë: apartament, nr. i pasurisë ****, sipërfaqja totale 117.8 m² në pronësi 100% të bashkëshortit të saj, shtetasit N.S.M.

26.6 Në deklaratën e pasurisë *Vetting*, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar si adresë regjistrimi: Njësia Bashkiake Nr. ***, në adresën rruga “****”, p. ***, h. ***, ap. ***, Tiranë.

26.7 Subjekti i rivlerësimit në pyetëSORIN standard ka sqaruar se: “*Sipas sistemit të adresave, ky apartament gjendet në rrugën “****, nd. ****, hyrja ****, ap. ****, Njësia Bashkiake Nr. ****, Zip Kod ****. Ndërsa në deklaratën Vetting, të depozituar në datën 26.1.2017, ky apartament është deklaruar në adresën: rruga “****”, pallati ****, hyrja ****, ap. **** (saktësimi i adresës është kryer nga Bashkia Tiranë, pas datës së kryerjes së deklarimit)*”. Subjekti ka depozituar si dokument adresarin e Bashkisë së Tiranës⁵⁵.

26.8 Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile informon⁵⁶ se shtetasi N.S.M figuron i regjistruar banor në Njësinë Administrative Nr. ****, Bashkia Tiranë. Komisionit nga verifikimi përkatës nuk i rezultuan problematika lidhur me adresat e banimit.

26.9 UKT⁵⁷ informon se në emër të shtetasit N.S.M nuk rezulton asnjë e dhënë apo kontratë e regjistruar me Shërbime Ujësjellës - Kanalizime sh.a. Subjekti⁵⁸ ka deklaruar se për këtë apartament ka qenë lidhur kontratë me UKT-në, me nr. ***. Fillimisht ka qenë në emër të firmës ndërtuese e, më pas, në emër të bashkëshortit N.M. Pas shitjes së apartamentit, kontrata ka kaluar në emër të blerësit.

26.10 FSHU⁵⁹ informon se me gjeneralitetet N.S.M identifikohet një abonent me kontratë furnizimi nr. ***, në instancën Tiranë. Nga të dhënat vihet re se kjo kontratë është në emër të shtetasit N.S.M, në adresën rruga “****”, ***, kategoria familjare, statusi aktiv.

⁵² Nr. ***rep., nr. *** kol., datë 15.10.2008, për apartamentin me sip. 125 m², lidhur midis E. dhe N.M dhe B.B (aneks nr. 4/9, administruar në dosjen e ILDKPKI-së).

⁵³ Nr. *** rep., nr. *** kol., datë 8.12.2011, depozituar në dokumentacionin shoqërues të pyetëSORIT standard.

⁵⁴ Nr. *** prot., datë 5.4.2012, depozituar në dokumentacionin shoqërues të pyetëSORIT standard, administruar në dosjen e Komisionit.

⁵⁵ Në përgjigje të pyetëSORIT standard, administruar në dosjen e Komisionit.

⁵⁶ Me shkresën nr. *** prot., datë 11.8.2021, administruar në dosjen e Komisionit.

⁵⁷ Me shkresën nr. *** prot., datë 16.7.2021, administruar në dosjen e Komisionit

⁵⁸ Me pyetëSORIN nr. 2, datë 30.4.2024, administruar në dosjen e Komisionit.

⁵⁹ Me shkresën nr. *** prot., datë 25.3.2021, administruar në dosjen e Komisionit.

26.11 Nga korrespondenca e administruar, RNSH⁶⁰ nuk konfirmon kontrata noteriale para vitit 2012.

26.12 DPPPP-ja⁶¹ me shkresën nr. *** prot., datë 27.4.2017, konfirmon se ka raportime të kontratave noteriale. Informacioni konfirmon se në datën 26.11.2009 shtetasi N.M ka shitur një apartament në shumën 62,000 euro, në favor të shtetasit L.LL, i datëlindjes 2.6.1957.

26.13 Për sa më sipër, Komisioni konstatoi se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar saktë dhe me vërtetësi apartamentin me sip. 125 m², pasuri me nr. ***, z. k. ***, në Tiranë, i cili është blerë prej tij para martesës me subjektin e rivlerësimit, është blerë së bashku me ish-bashkëshorten dhe që, më pas, me ndarjen e tyre janë dakordësuar që bashkëshorti të marrë apartamentin dhe bashkëshortja të shlyhet në vlerë leku.

26.14 Bazuar në faktet e dala, Komisioni konstatoi se kjo pasuri me origjinë krijimi të saj prej një regjimi tjetër martesor, pa kurrfarë lidhjeje me subjektin e rivlerësimit, nuk ndikon këtë hetim administrativ e, për rrjedhojë, pozitën e saj në përmbushje të qëllimit të ligjit nr. 84/2016.

27. Pasuri e luajtshme, automjet tip “Opel Astra”, nr. shasie ***, sipas certifikatës së pronësisë së mjetit rrugor të lëshuar datë 6.5.2014. Shitblerja është kryer sipas të dhënave të kontratës noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 5.4.2014. Burimi i krijimit: kursimet nga pagat (të ardhurat personale). Vlera: 4,400 euro. Pjesa takuese: 50%.

Kjo pasuri është trajtuar/analizuar nga trupi gjykues tek deklarimi i pasurive të subjektit të rivlerësimit, duke vlerësuar këtu e në vijim të mos bjerë në përsëritje.

28. Llogari rrjedhëse pranë Alpha Bank me nr. ***, gjendja e llogarisë deri në datën 10.1.2017, e përcaktuar sipas gjendjes së llogarisë. Burimi i krijimit: të ardhurat personale/pagat. Vlera: 160,295.39 lekë. Pjesa takuese: 50%. Trajtuar/analizuar nga trupi gjykues tek deklarimi i pasurive të subjektit të rivlerësimit.

29. Llogari rrjedhëse pranë BKT-së. Burimi i krijimit: pagesat e përfituara në formën e dëmshpërblimit për largim të padrejtë nga puna, ATSH, në vlerën 941,045 lekë; pjesërisht nga kursimet e të ardhurave të subjektit dhe të bashkëshortit. Vlera: 18,192.80 euro. Pjesa takuese: 50%. Trajtuar/analizuar nga trupi gjykues tek deklarimi i pasurive të subjektit të rivlerësimit.

30. Gjendje cash nga të ardhurat personale të subjektit dhe të ardhurat personale të bashkëshortit, si dhe bonuset e përfituara nga puna që kryen. Vlera: 1,350,000 lekë. Pjesa takuese: 50%. Trajtuar/analizuar nga trupi gjykues tek deklarimi i pasurive të subjektit të rivlerësimit.

31. Llogari rrjedhëse në Tirana Bank. Vlera: 475 lekë. Pjesa takuese: 100%. Bashkëlidhur deklaratës subjekti ka depozituar nxjerrje llogarie të datës 16.1.2017 nga Tirana Bank, me gjendje 475 lekë.

31.1 ILDKPKI-ja në raportin e saj është shprehur: *Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar me përgjigjen e Tirana Bank.*

31.2 Tirana Bank⁶² informon se shtetasi N.M ka pasur llogari pranë kësaj banke. Gjendja e llogarisë në datën 27.1.2017 kur është depozituar deklarata *Vetting* është 475 lekë. Konstatohet se përputhet deklarimi i subjektit me përgjigjen e ardhur nga Tirana Bank.

⁶⁰ Me shkresën nr. *** prot., datë 16.7.2021, administruar në dosjen e Komisionit.

⁶¹ Me shkresën nr. *** prot., datë 27.4.2017 (aneks nr. 34 në dosjen e ILDKPKI-së).

⁶² Shkresë nr. *** prot., datë 23.7.2021.

32. Llogari rrjedhëse në Credins Bank. Vlera: 41,004.11 lekë. Pjesa takuese: 100%. Bashkëlidhur deklaratës subjekti ka depozituar⁶³ nxjerrje llogarie të datës 16.1.2017 nga Credins Bank të shtetasit N.M, me balancë 39,901.45 lekë.

32.1 ILDKPKI-ja në raportin e saj është shprehur: *Dokumentacioni i paraqitur nga subjekti i përket datës 16.1.2017, ndërsa konfirmimi i Credins Bank i përket datës 27.1.2017.*

32.2 Credins Bank⁶⁴ informon se shtetasi N.M ka llogari pranë kësaj banke. Gjendja e llogarisë në datën 27.1.2017 kur është depozituar deklarata *Vetting* është 39,901 lekë. Konstatohet se përputhet deklarimi i subjektit me përgjigjen e ardhur nga Credins Bank.

33. Llogari rrjedhëse në Alpha Bank. Vlera: 2,651.43 lekë. Pjesa takuese: 100%. Bashkëlidhur deklaratës subjekti ka depozituar nxjerrje llogarie⁶⁵ të datës 24.1.2017 nga Alpha Bank, me gjendje në datën 23.1.2017 në shumën 2,651.43 lekë.

33.1 ILDKPKI-ja në raportin e saj është shprehur: *Ndryshimi midis gjendjes së deklaruar dhe asaj të konfirmuar nga banka ka ndodhur për shkak të paraqitjes së tyre në dy data të ndryshme dhe, konkretisht, deklarimi i përket datës 23.1.2017, ndërsa kërkesa dhe konfirmimi i bankës i përket datës 27.1.2017.*

33.2 Alpha Bank⁶⁶ informon se shtetasi N.M ka llogari pranë kësaj banke. Nga hetimi rezulton se në këtë llogari bashkëshortit të subjektit i kreditohet paga. Gjendja e llogarisë në datën 27.1.2017 kur është depozituar deklarata *Vetting* është 104,715.68 lekë. Konstatohet se ndryshimi midis gjendjes së deklaruar dhe asaj të konfirmuar nga banka vjen si rezultat i paraqitjes së tyre në dy data të ndryshme.

Detyrime financiare, deklaruar nga bashkëshorti N.M

34. Kredi bankare, marrë nga bashkëshortja, sipas të dhënave të kontratës noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.9.2012, me kredihënës BKT, dega “****”, Tiranë. Totali i kredisë: 2,847,600 lekë. Detyrimi i mbetur: 2,369,061.54 lekë. Kjo kredi është trajtuar/analizuar nga trupi gjykues tek detyrimet e deklaruara nga subjekti, duke vlerësuar këtu e në vijim të mos bjerë në përsëritje.

35. Hua sipas të dhënave të kontratës noteriale në vlerën 27,000 euro, për shlyerje detyrimi. Detyrimi i mbetur 20,000 euro. Kjo hua është trajtuar/analizuar nga trupi gjykues tek detyrimet e deklaruara nga subjekti.

36. Pagesë detyrimi familjar në shumën fikse 10,000 lekë/muaj. Kjo pagesë është trajtuar/analizuar tek detyrimet e deklaruara nga subjekti.

Konkluzion përfundimtar mbi pasurinë

Në përfundim të procesit të rivlerësimit, referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe dispozitave të kreut IV të ligjit nr. 84/2016, Komisioni krijoi bindjen se subjekti i rivlerësimit Majlinda Miska ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e kriterit të pasurisë.

B. KONTROLI I FIGURËS

⁶³ Aneks nr. 4/11 në dosjen e ILDKPKI-së.

⁶⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 24.8.2021.

⁶⁵ Aneks nr. 4/12 në dosjen e ILDKPKI-së.

⁶⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 22.7.2021.

37. Autoriteti Kombëtar i Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar (AKSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës të ligjit nr. 84/2016. Për këtë qëllim, AKSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar raportin mbi kontrollin e figurës nr. *** prot., datë 2.11.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. *** prot., datë 9.4.2024, të KDZH-së, me konstatimin për përshtatshmërinë në vazhdimin e detyrës të subjektit Majlinda Miska.

Hetimi i Komisionit

37.1 Komisioni, në vijim, si organi i legjitimuar nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 për të bërë rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ka hetuar në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të lartpërmendur, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

37.2 Më tej, pas kërkesës së Komisionit për përditësimin e informacioneve, AKSIK-ja⁶⁷ nuk ka konfirmuar të dhëna të përditësuara për përfshirje në veprimtari të kundërligjshme.

37.3 Komisioni, si organ i legjitimuar nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 për të bërë rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ka hetuar në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

37.4 Në përfundim të rivlerësimit për kriterin e kontrollit të figurës, Komisionit i rezultoi se subjekti i rivlerësimit Majlinda Miska arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të nenit 59/1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, pasi nga verifikimet e kryera nuk rezultoi se ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ka dorëzuar në kohë deklaratën për figurën, si dhe nuk ka kryer deklarime të pasakta ose nuk ka fshehur kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

38. Subjekti i rivlerësimit Majlinda Miska është diplomuar në vitin 2000 në Universitetin e Tiranës, dega Drejtësi. Në vitin 2004 ka fituar titullin e Avokatit dhe është regjistruar në Dhomën e Avokatëve Tiranë. Me vendimin nr. ***, datë 31.7.2013, të Komisionit të Licencimit të Ndërmjetësimit, është pajisur me Licencën e Ndërmjetësit. Subjekti i rivlerësimit Majlinda Miska ka filluar karrierën e saj fillimisht në Këshillin e Qarkut Tiranë, më pas në Agjencinë Telegrafike Shqiptare, ALUIZNI qarku Tiranë, AKSHI dhe DPTT Vendore Tiranë. Në korrik 2015 ka filluar të ushtronte detyrën e ndihmëses ligjore pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, detyrë të cilën e ushtron edhe aktualisht.

38.1 Hetimi i Komisionit lidhur me kriterin e vlerësimit profesional të subjektit të rivlerësimit është bazuar në analizimin e:

- i) raportit⁶⁸ të hartuar nga KLGJ-ja për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit;

⁶⁷ Me shkresën e datës 8.5.2024.

⁶⁸ Raporti nr. *** prot., datë 23.2.2023, i KLGJ-së, administruar nga Komisioni.

- ii) kriterëve të vlerësimit të parashikuara në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (neni 71 e vijues i tij);
- iii) denoncimet e paraqitura sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016⁶⁹.

38.2 Raporti është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e:

- formularit të vetëdeklarimit;
- të dhënave nga burimet arkivore të KLGJ-së;
- 3 dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave të dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit;
- 5 dosjeve gjyqësore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor.

Gjetjet nga formulari i vetëdeklarimit dhe dokumentet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit

38.3 Nga analiza e dokumentacionit të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, konstatohet se formulari është plotësuar sipas formës standarde, në mënyrë të plotë, me faqe të nënshkuara rregullisht, pa mangësi nga pikëpamja formale dhe po ashtu edhe përvoja e saj profesionale në 10 vitet e fundit⁷⁰ duket të jetë e zhvilluar.

a) Detyrat e kryera 3 vitet e fundit dhe të dhënat statistikore

Subjekti i rivlerësimit Majlinda Miska lidhur me fushën e të drejtës, ku ka punuar 3 vitet e fundit, në formularin e vetëdeklarimit ka sqaruar si vijon: “*E Drejta Administrative; E Drejta Civile*”. Referuar të dhënave të formularit të vetëdeklarimit, rezulton se subjekti i rivlerësimit Majlinda Miska si ndihmëse ligjore ka më pak se 3 vite punë. Konkretisht, për periudhën objekt i rivlerësimit kalimtar, ajo ka një periudhë pune prej një viti e tre muaj (korrik 2015 – 8.10.2016). Në periudhën 8.10.2013 – qershor 2015, znj. Majlinda Miska ka ushtruar funksionin e juristes në sektorë të ndryshëm të administratës shtetërore. Në lidhje me fushën e specializimeve, subjekti Majlinda Miska në formularin e vetëdeklarimit nuk ka deklaruar të tilla.

b) Trajnimet në 3 vitet e fundit

Subjekti i rivlerësimit Majlinda Miska në formularin e vetëdeklarimit ka deklaruar disa trajnime në Shkollën e Magjistraturës⁷¹ në 3 vitet e fundit të ushtrimit të detyrës, si dhe të tjera

⁶⁹ Ligji nr. 84/2016, neni 53 “Pjesëmarrja e publikut në denoncimin e fakteve”: “1. Çdo person që vjen në dijeni të fakteve ose rrethanave që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit ka të drejtë të informojë drejtpërdrejt institucionet e rivlerësimit. Institucioni i rivlerësimit është i detyruar të kontrollojë nëse informacioni është dhënë nga një person i njohur ose anonim. 2... etj.”.

⁷⁰ Sipas të dhënave të deklaruara në rubrikën B të formularit (të dhëna për punësimin), subjekti i rivlerësimit Majlinda Miska ka deklaruar se: (i) për periudhën nëntor 2003 – dhjetor 2007 ka punuar pranë Agjencisë Telegrafike Shqiptare, në pozicionin e drejtores së Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve; (ii) për periudhën 12.2007 – 1.2008 ka qenë pa punë; (iii) për periudhën janar 2008 – shtator 2008 ka punuar pranë ALUIZNI-t të qarkut Tiranë, në pozicionin e përgjegjëses së sektorit të kompensimit; (iv) për periudhën tetor 2008 – nëntor 2008 ka punuar pranë Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave/Ndërtime informale, duke ushtruar detyrën e këshilltares ligjore; (v) për periudhën nëntor 2008 – prill 2010 ka punuar pranë Agjencisë Kombëtare dhe Shoqërisë së Informacionit, duke ushtruar detyrën e specialistes; (vi) për periudhën prill 2010 – shkurt 2014 ka punuar sërish pranë Agjencisë Kombëtare dhe Shoqërisë së Informacionit, duke ushtruar këtë herë detyrën e përgjegjësit në sektorin e administrimit të investimeve ICT; (vii) për periudhën shkurt 2014 – mars 2014 ka qenë pa punë; (viii) për periudhën mars 2014 – shkurt 2015 ka punuar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore Tiranë, duke kryer detyrën e specialistes/juristes; (ix) për periudhën shkurt 2015 – korrik 2015 ka punuar sërish pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore Tiranë, duke ushtruar këtë herë detyrën e përgjegjësit të sektorit; (x) ndërkohë, në periudhën korrik 2015 e në vazhdim, pra edhe aktualisht, znj. Majlinda Miska ushtron funksionin e ndihmëses ligjore në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.

⁷¹ Trajnim me temë “Jurisprudenca e GJEDNJ-së lidhur me të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. Konventa e OKB dhe legjislacioni shqiptar me PMK dhe roli i sistemit të drejtësisë”. Trajnim i zhvilluar në datën 3 nëntor 2016. Trajnim me temë

trajtime jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës dhe, po ashtu, ka depozituar edhe dokumentacionin provues.

Të dhëna nga burime arkivore të KLGJ-së

38.4 Për subjektin e rivlerësimit Majlinda Miska nuk ka të dhëna në burimet arkivore të KLGJ-së për periudhën e rivlerësimit, për shkak se ndihmësit ligjor ishin njësi e brendshme e organizuar dhe vareshin nga gjykatat administrative. Për rrjedhojë, të dhënat profesionale dhe etike të tyre i disponojnë gjykatat përkatëse ku ata kanë ushtruar detyrën si ndihmës ligjorë.

Analiza e gjetjeve

38.5 Analiza e gjetjeve u referohet të dhënave të nxjerra nga tri grupet e burimeve të informacionit: (i) formulari i vetëvlerësimit; (ii) dokumentacioni i paraqitur nga subjekti; (iii) 5 dokumentet ligjore të vëzhguara, të përzgjedhura me short.

Aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

Procesi i rivlerësimit kalimtar të ndihmësve ligjorë pranë gjykatave administrative parashikohet dhe rregullohet nga neni 42, pika 2 e ligjit nr. 84/2016⁷², “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe nga neni 165 i ligjit nr. 96/2016⁷³, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Referuar parashikimeve ligjore e nënligjore në fuqi për kohën kur kryhet ky proces vlerësimi profesional për ndihmësit ligjorë, ndryshe nga magjistratët-gjyqtarë, nuk ka pasur të miratuar nga një organ kompetent një Sistem Vlerësimi Profesional. Për rrjedhojë, për ndihmësit ligjorë në gjykatat administrative nuk ka kriteret matëse të punës sikurse ato kanë ekzistuar për magjistratët-gjyqtarë, prandaj vlerësimi i aftësive profesionale të tyre nuk ndjek detyrimisht të njëjtat rregulla si për magjistratët-gjyqtarë. Në këto kushte, vlerësimi i aftësive profesionale të ndihmësve ligjorë pranë gjykatave administrative kryhet në përputhje me parashikimin e nenit 42, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 të sipërcituar, si dhe bazuar në përmbajtjen e nenit 6, pika 2 e ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar më vonë. Lidhur me subjektin e rivlerësimit Majlinda Miska, për zotërimin prej saj të njohurive ligjore, ndër të tjera pasqyrohet:

- Znj. Majlinda Miska ka filluar punë si ndihmëse ligjore pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, pas emërimit të saj në datën 13.7.2015, fakt i rezultuar nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë⁷⁴.

- Për periudhën objekt i rivlerësimit kalimtar (8.10.2013 – 8.10.2016), znj. Majlinda Miska ka ushtruar detyrën e ndihmës ligjore përafërsisht për 1 vit e 3 muaj (13.7.2015 – 8.10.2016).

“Zhvillimet e legjislationit të prokurimeve publike dhe atij fiskal në këndvështrimin e gjykimin administrativ”. Trajnim i zhvilluar në datën 28 tetor 2015. Trajnim me temë “Tatimi mbi vlerën e shtuar. Tatimi mbi të ardhurat dhe taksimi ndërkombëtar në ndihmë të gjykimin administrativ”. Trajnim i zhvilluar në datat 5 dhe 6 tetor 2016. Trajnim me temë “Zbatimi i drejtësisë administrative në Shqipëri, rastet procedurale. Trajnim i zhvilluar në datën 4 nëntor 2015”.

⁷² Ligji nr. 84/2016, neni 42, pika 2 parashikon: “Këshilltari ligjor i Gjykatës Kushtetuese, ndihmësi ligjor i Gjykatës së Lartë, Gjykatës Administrative, si dhe ndihmësi ligjor në Prokurorinë e Përgjithshme, të cilët nuk janë magjistratë, vlerësohen bazuar në:

a) relacionet dhe mendimet ligjore të përgatitura; dhe b) rezultatet e testimit pranë Shkollës së Magjistraturës”.

⁷³ Ligji nr. 96/2016, neni 165, pika 1: “Këshilltari i gjyqarit pranë Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, ndihmësi ligjor pranë Prokurorisë së Përgjithshme dhe në gjykatat administrative, si dhe inspektori në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, që nuk gëzon statusin e gjyqarit ose prokurorit, janë subjekt i procesit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin “Për rivlerësimin kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

⁷⁴ Me shkresën nr. *** prot., datë 2.8.2021, të Gjykatës Administrative të Apelit, depozituar në raportin profesional.

Referuar parashikimit të nenit 41, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, në rast se subjekti i rivlerësimit ka më pak se 3 vite në detyrë, periudhë vlerësimi konsiderohet e gjithë koha gjatë ushtrimit të detyrës.

- Para emërimit në detyrën e ndihmëses ligjore pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, znj. Majlinda Miska rezulton të ketë pasur edhe eksperiencë të tjera si juriste, por edhe në nivel drejtues në institucione të ndryshme shtetërore, detyra në të cilat ka dhënë eksperiencën e saj ligjore.

- Referuar të dhënave, subjekti i rivlerësimit Majlinda Miska ka një eksperiencë mjaft të pasur në njohjen e ligjit, bazuar në detyrat që ajo ka kryer dhe që u cituan më lart, veçanërisht eksperiencë e saj pranë ALUIZNI-t i ka dhënë asaj njohuri mjaft të mira në Të Drejtën Administrative, por edhe Civile. Kjo eksperiencë e pasur e ndihmon atë të kryejë me profesionalizmin e duhur detyrën e ndihmëses ligjore në Gjykatën Administrative të Apelit.

- Ndhimësi ligjor është njësi ndihmëse, pjesë e organizimit të brendshëm të gjykatave administrative. Në nenin 6, pika 1 e ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” përcaktohet se: *“Gjyqtari i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit Administrativ në veprimtarinë e tij ndihmohet nga ndihmësi ligjor”*.

- Ndërsa në nenin 6, pika 2 e ligjit nr. 49/2012, detajohen detyrat e ndihmëses ligjore, ku shprehimisht thuhet: *“Ndhimësi ligjor ndihmon dhe këshillon gjyqtarin lidhur me përgatitjen e çështjes për gjykim dhe shqyrtimin gjyqësor, si dhe përgatit projektaktet procedurale të nevojshme për gjykimin. Me kërkesë të gjyqtarit, ndihmësi ligjor bën kërkime ligjore dhe përgatit opinione me shkrim për problematika ligjore të karakterit procedural dhe material që lidhen me çështjet në gjykim”*.

Aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Subjekti i rivlerësimit Majlinda Miska rezulton se ka ushtruar detyrën e ndihmëses ligjore pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë nga data e emërimit të saj (13.7.2015) e në vazhdim. Në funksionin e ndihmësit ligjor pranë kësaj gjykate, ajo ka deklaruar se në periudhën korrik 2015 – 8.10.2016 ka përpiluar 415 draft-relacione, nga të cilat për 375 çështje për të cilat është dhënë vendim dhe për 40 çështje të papërfunduara me vendim përfundimtar. Ndhimësi ligjor nuk ka çështje të mbartura, pasi ai shqyrton aq çështje sa nxjerr gjyqtari për gjykim. Këto të dhëna statistikore janë pasqyruar nga vetë subjekti në formularin e vetëvlerësimit profesional. Ndërsa, sipas informacionit zyrtar të paraqitur nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, për efekt të organizimit të përzgjedhjes së 5 çështjeve me short rezulton se për periudhën korrik 2015 – 8.10.2016, subjekti i rivlerësimit ka asistuar gjyqtarët K.S dhe F.P në përgatitjen dhe përpunimin e 223 çështjeve (relacione apo projektvendime). Evidentohet fakti se për subjektin e rivlerësimit nuk ka të dhëna direkte për ngarkesën dhe punën e saj, por të dhënat janë nxjerrë nga dosjet gjyqësore të gjyqtarit pranë të cilit ajo është caktuar të asistojë. Kuadri ligjor në fuqi për kohën kur kryhet ky vlerësim profesional nuk përcakton standarde minimale pune për ndihmësin ligjor të Gjykatës Administrative të Apelit. Puna e ndihmësit ligjor është e lidhur direkt me veprimtarinë e gjyqtarit që ai asiston, pra ndihmësi kryen ato detyra që i caktohen nga vetë gjyqtari. Nga të dhënat statistikore të deklaruara nga vetë ndihmësja ligjore, znj. Majlinda Miska, por edhe ato të dhëna të përcjella nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë

për efekt të shortit, duket se subjekti i rivlerësimit ka përfunduar në kohë detyrat e ngarkuara nga gjyqtari të cilin ka asistuar.

b) Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore

Detyrat e ndihmësit ligjor të gjykatave administrative janë parashikuar në nenin 6 të ligjit nr. 49/2012 dhe, konkretisht, në paragrafët 1 e 2 të tij, ku sanksionohet se: “1. Gjyqtari i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë dhe i Gjykatës së Apelit Administrativ në veprimtarinë e tij ndihmohet nga ndihmësi ligjor. 2. Ndihmësi ligjor ndihmon dhe këshillon gjyqtarin lidhur me përgatitjen e çështjes për gjykim dhe shqyrtimin gjyqësor, si dhe përgatit projektakte procedurale të nevojshme për gjykimin. Me kërkesë të gjyqtarit, ndihmësi ligjor bën kërkime ligjore dhe përgatit opinione me shkrim për problematika ligjore të karakterit procedural dhe material që lidhen me çështjet në gjykim”. Rezulton qartë nga përmbajtja e ligjit të sipërcituar se ndihmësi ligjor nuk kryen procedura gjyqësore. Ky kriter vlerësimi shërben dhe zbatohet vetëm për gjyqtarin, i cili i ka të përcaktuara qartësisht në ligj detyrat e tij procedurale, duke filluar që nga data e marrjes me short të çështjes e deri në datën e përfundimit të saj me vendim përfundimtar.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Edhe ky kriter vlerësimi zbatohet vetëm për gjyqtarët. As në ligjin nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative” dhe në asnjë ligj apo akt nënligjor tjetër nuk parashikohet si detyrë për ndihmësin që të administrojë një dosje gjyqësore.

Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Nga të dhënat e dërguara nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë me shkresën nr. *** prot., datë 20.1.2023, nuk rezultojnë të dhëna negative për etikën në punë të znj. Majlinda Miska, për periudhën gjatë së cilës ajo ka ushtruar detyrën e ndihmëses ligjore pranë asaj gjykate (13.7.2015 – 8.10.2016). Gjithashtu, nga përmbajtja e po kësaj shkrese rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë objekt i ndonjë procedimi disiplinor për shkelje disipline.

b) Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit Majlinda Miska, nga të dhënat e dërguara nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, por edhe nga dokumentet e vëzhguara, konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna negative në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c) Paanësia

Ky element vlerësues është tipik për gjyqtarin, i cili ka detyrimin ligjor jo vetëm të jetë i paanshëm në një proces gjyqësor, por edhe duhet të sillet si i tillë sipas parimit “Drejtësia jo vetëm duhet të jepet, por edhe duhet të duket se po jepet”. Ndihmësi ligjor nuk ka kontakte me palët ndërgjyqëse, pasi nuk është pjesëmarrës në një proces gjyqësor dhe as subjekt procedural. Ndihmësi ligjor nuk është organ vendimmarrës, por këshillues, asistues i gjyqtarit. Në tetë relacionet e përgatitura nga ndihmësja ligjore Majlinda Miska nuk konstatohen elemente favorizuese apo njëanshmërie në raport me palët ndërgjyqëse pjesëmarrëse në ato procese gjyqësore që iu korrespondojnë atyre relacioneve.

Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a) Aftësitë e komunikimit

Rezultoi se znj. Majlinda Miska ka filluar punë si ndihmëse ligjore pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë në datën 13.7.2015, fakt i pasqyruar në shkresën nr. *** prot., datë 2.8.2021, dërguar nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë. Me urdhër të Kryetarit të asaj gjykate, znj. Majlinda Miska është caktuar të asistojë fillimisht gjyqtarin K.S në periudhën 13.7.2015 – 13.4.2016 dhe gjyqtaren F.P në periudhën 14.4.2016 e në vazhdim. Në të 8 dokumentet ligjore të vëzhguara nuk ka të dhëna për mënyrën e komunikimit të subjektit të rivlerësimit Majlinda Miska me palët ndërgjyqëse, pasi për shkak të natyrës së punës nuk ka kontakt me ta, ndërsa gjuha e përdorur në aktet e përpiluara prej saj mund të vlerësohet si korrekte dhe normale. Në lidhje me aftësitë e ndihmëses ligjore Majlinda Miska për të komunikuar me gjyqtarët e Gjykatës Administrative të Apelit, me drejtuesin e Gjykatës apo edhe me pjesëtarë të stafit administrativ të asaj gjykate, nuk janë evidentuar probleme.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 relacionet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit të rivlerësimit për të bashkëpunuar me gjyqtarët, kolegët e tyre dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta. Ndërkohë, në asnjë prej relacioneve të vëzhguara dhe praktikave përkatëse të trajtuara gjatë këtij procesi rivlerësimi nuk është evidentuar ndonjë problematikë në bashkëveprimin e saj me gjyqtarët të cilët ka asistuar.

Tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit

38.6 Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur 3 relacione⁷⁵ të përpiluara prej saj në cilësinë e ndihmësit ligjor. Në të 3 relacionet ndihmësi ligjor ka dhënë opinion ligjor për zgjidhjen e çështjes nga Gjykata Administrative e Apelit, duke identifikuar saktë legjislacionin e zbatueshëm për zgjidhjen e kësaj çështjeje gjyqësore administrative.

Rivlerësimi i Komisionit për 3 dokumentet e përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit

38.7 Në analizë të 3 dokumenteve (relacioneve) të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit duket se nga pikëpamja formale rezultojnë të jenë përgatitur dhe përpiluar në përputhje me parashikimet e nenit 6, pika 2 e ligjit nr. 49/2012⁷⁶. Subjekti i rivlerësimit ka trajtuar në këto

⁷⁵ **Dokumenti 1** – Relacion mbi çështjen administrative nr. ***(***) , datë 25.2.2016 regjistrimi, që i përket paditësit shoqëria “****” sh.p.k., kundër të paditurit ISHTI, me objekt “Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ, akt konstatimi nr. *** prot., datë 11.5.2015, kryer nga IQT, një organ i paidentifikuar. Shfuqizimin e aktit administrativ vendim gjobë nr. *** prot., datë 17.6.2015 “Për gjobë subjektit “****” sh.p.k., në masën 4.000.000 lekë dhe vendosur nga ISHTI dhe akt kontrollit nr. *** prot., datë 11.5.2015, kryer nga IQT, një institucion i paidentifikuar”; **Dokumenti 2** – Relacion mbi çështjen administrative nr. ***(***) , datë 6.11.2015 regjistrimi, që i përket paditësit T.B, kundër të paditurit Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Sh, me objekt “Kundërshtim vendimi nr. *** , datë 22.7.2011, i Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Sh dhe vendimi nr. *** , datë 23.2.2011, i KQA. Detyrimin e DRSSH Sh për pagimin e pensionit maksimal nga data e lindjes së tij dhe diferencat përkatëse”; **Dokumenti 3** – Draft-vendim mbi çështjen administrative nr. *** regjistri themeltar, datë 9.12.2014 regjistrimi, që i përket paditësit shoqëria “****” sh.p.k., kundër të paditurve Drejtoria Rajonale Tatimore T dhe Drejtoria e Apelit Tatimor T, me objekt “Anulimin e aktit administrativ “Njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore” nr. *** prot., datë 29.12.2010, “Njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore” nr. *** prot., datë 27.1.2011, vendimin nr. *** prot., datë 16.5.2011 dhe nr. *** prot., datë 27.4.2011, të KAT”.

⁷⁶ Ligji nr. 49/2012, neni 6 pika 2, Ndihmësi ligjor ndihmon dhe këshillon gjyqtarin lidhur me përgatitjen e çështjes për gjykim dhe shqyrtimin gjyqësor, si dhe përgatit projekt-akte procedurale të nevojshme për gjykimin. Me kërkesë të gjyqtarit, ndihmësi ligjor bën kërkime ligjore dhe përgatit opinione me shkrim për problematika ligjore të karakterit procedural dhe material që lidhen me çështjet në gjykim.

tri relacione mosmarrëveshje që lidhen me: (i) konstatimin e pavlefshmërisë së aktit administrativ (shihni dokumentin 1); (ii) ankimit mbi procedurën administrative të drejtës së pagimit të pensionit (shihni dokumentin 2); (iii) draft-vendimin mbi anulimin e aktit administrativ (shihni dokumentin 3).

38.8 Subjekti i rivlerësimit, në përmbajtje të 2 relacioneve (dokumentet 1 dhe 2) dhe 1 draft -vendimi (dokumenti 3), ka relatuar mosmarrëveshjet objekt gjykimi, palët ndërgjyqëse, pretendimet dhe prapësimet e palëve ndërgjyqëse, ka cituar të gjitha disponimet dhe arsyetimet e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, si dhe ka listuar shkaqet e ankimit të bërë nga secila palë ndërgjyqëse. Në përpilimin e tyre subjekti ka marrë në analizë ligjore, si vendimin e shkallës së parë të gjykimit, ashtu edhe shkaqet e ankimit të ushtruar ndaj tij nga palët respektive. Gjithashtu ka dhënë të argumentuar qëndrimin e Gjykatës Administrative të Apelit, si dhe ka treguar arsyet se përse kjo gjykatë e vlerësoi të gabuar zgjidhjen e dhënë nga Gjykata Administrative e Shkallës Parë (shihni dokumentin 1).

38.9 Subjekti ka dhënë opinion ligjor për zgjidhjen e çështjeve nga Gjykata Administrative e Apelit, duke identifikuar saktë legjislacionin e zbatueshëm për zgjidhje të çështjeve gjyqësore administrative (shihni dokumentet 1, 2 dhe 3).

38.10 Pas kërkesës së Komisionit⁷⁷, Gjykata Administrative e Apelit⁷⁸ depozitoi tri vendimet gjyqësore të dhëna për këto çështje. Nga analiza krahasuese e vendimeve të Gjykatës dhe relacioneve të konceptuara nga subjekti i rivlerësimit rezultoi se tri relacionet e konceptuara nga subjekti janë pasqyruar në vendimet gjyqësore.

- Në përfundim të analizës së kryer për tri dokumentet e përzgjedhura, Komisioni nuk konstatoi problematika lidhur me vlerësimin profesional, të subjektit të rivlerësimit.

Përshkrimi i 5⁷⁹ dokumenteve ligjore të përzgjedhura me short

⁷⁷ Me shkresën nr. *** prot., datë 23.2.2024, administruar në dosjen e Komisionit.

⁷⁸ Me shkresën nr. *** prot., datë 28.2.2024. Tri vendimet e depozituara nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, administruar në dosjen e Komisionit.

⁷⁹ **Dokumenti 4** – Çështja administrative nr. *** akti, datë 26.11.2015, që u përket palëve ndërgjyqëse: paditës K.R, kundër të paditurve DPTRR dhe DRSHTRR, palë e tretë RBS, me objekt “Detyrimi për të regjistruar kontratën e shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 4.9.2014, të noteres SH.GJ dhe për të lëshuar certifikatën përkatëse të pronësisë dhe lejen e qarkullimit për automjetin me targë *** në emër të paditësit. Konstatimi i pavlefshmërisë dhe fshirja e masës së bllokimit të vendosur për këtë automjet, me nr. bllokimi ***, datë 13.6.2014”. Kjo çështje u përfundua së gjykuari nga Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. ***, datë 22.12.2015; **Dokumenti 5** – Çështja administrative nr. *** akti, datë regjistrimi 23.10.2014, që u përket palëve ndërgjyqëse: paditëse S.P, kundër të paditurve Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme T, ZQRPP, person i tretë G.K, me objekt “Anulimin e aktit administrativ nr. ***, datë 23.11.2011, të Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme T. Detyrimin e palës së paditur të më pajisë me vërtetim pronësie”. Kjo çështje ka përfunduar së gjykuari nga Gjykata Administrative e Apelit me vendimin nr. ***, datë 7.7.2016; **Dokumenti 6** – Çështja administrative nr. *** akti, datë 1.6.2015, që u përket palëve ndërgjyqëse: paditës P.Q, kundër të paditurit Ministria e F, Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike Bashkia T, Drejtoria e Përgjithshme E, me objekt “Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ nr. *** prot., datë 6.7.2004, të lëshuar nga Drejtoria Ekonomike e Bashkisë T, për sa i përket vlerës ekonomike të truallit, numrit të kateve, si dhe sipërfaqes së ndërtimit. Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të shkresës nr. ***, datë 15.2.2009, lëshuar nga Sektori i Shitjes së Pronave Publike, për të cilin ka llogaritur sipërfaqen e truallit dhe rregullimin e pasojave sipas vendimit të dhënë nga gjykata”, e përfunduar nga Gjykata Administrative e Apelit me vendimin nr. ***(***) , datë 25.9.2015; **Dokumenti 7** – Çështja administrative nr. *** akti, datë 8.10.2014, që u përket palëve ndërgjyqëse: paditës H.H, kundër të paditurve Drejtoria Rajonale e Agjencisë së Legalizimit Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave Informale D, Drejtoria e Përgjithshme e ALUIZNI-t T, me objekt “Detyrimin e palës së paditur Drejtoria Rajonale e Agjencisë së Legalizimit Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave Informale D të paguajë paditësin H.H për periudhën e afatit të njoftimit për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës nga punëdhënësi, në masën e 2 (dy) muajve pagë etj.”. Kjo çështje është përfunduar nga Gjykata Administrative e Apelit me vendimin nr. *** , datë 16.6.2016; **Dokumenti 8** – Çështja administrative nr. *** akti, datë 28.10.2014, që u përket palëve ndërgjyqëse: paditës A.Q, kundër të paditurit DPPSH, me objekt “Shfuqizimin e urdhrin nr. *** , datë 12.2.2014 “Për lirim

38.11 Raporti për të gjitha këto dokumente (nr. 4, 5, 6, 7 dhe 8), lidhur me relacionin e përgatitur nga ndihmësja ligjore Majlinda Miska, ka konfirmuar si vijon:

i. Relacioni nga pikëpamja formale rezulton të jetë përgatitur dhe përpiluar në përputhje me parashikimet e nenit 6, pika 2 e ligjit nr. 49/2012.

ii. Ndihmësja ligjore në përmbajtje të relacionit ka relatuar mosmarrëveshjet objekt gjykimi, objektin, bazën ligjore të padisë, palët ndërgjyqëse, pretendimet dhe kërkimet e palës paditëse dhe prapësimet e palës së paditur. Ka cituar në mënyrë të sintetizuar disponimet dhe arsyetimet e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë në funksion të zgjidhjes së çështjes, argumentet ligjore të saj për lënien në fuqi ose jo të vendimit etj.

iii. Ndihmësja ligjore ka listuar shkaqet e ankimit të bërë nga pala, argumentet ligjore të kësaj pale me të cilat kundërshtohet si i pabazuar vendimi i shkallës së parë, si dhe arsyet përse kërkohet prishja/ndryshimi i vendimit.

iv. Në tërësi për të gjitha këto dokumente, raporti është shprehur se nga verifikimi fizik i secilës dosje nuk rezultojnë akte administrative të nënshkruara nga ndihmësja ligjore Majlinda Miska, të tilla si relacione, draft-vendime, opinione ligjore etj.

Rivlerësimi i Komisionit për 5 dosjet e përzgjedhura me short

a) Në analizë të 5 dokumenteve (relacioneve)⁸⁰ të përzgjedhura me short duket se nga pikëpamja formale rezultojnë të jenë përgatitur dhe përpiluar në përputhje me parashikimet e nenit 6, pika 2 e ligjit nr. 49/2012⁸¹.

b) Në analizë të 5 dosjeve të përzgjedhura me short, nga të dhënat e depozituara në raportin profesional, vihet re se:

i. Janë përzgjedhur brenda periudhës së rivlerësimit të subjektit. Duket se në dokumentet relacione të çështjeve janë relatuar mosmarrëveshjet objekt gjykimi, palët ndërgjyqëse, pretendimet dhe prapësimet e palëve ndërgjyqëse, janë cituar të gjitha disponimet dhe arsyetimet e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, si dhe janë listuar shkaqet e ankimit të bërë nga secila palë ndërgjyqëse.

ii. Në këto relacione mungon arsyetimi ligjor për zgjidhjen e çështjes nga Gjykata Administrative e Apelit.

iii. Relacionet janë të konceptuara dhe të firmosura në emër të gjyqtarit relator të çështjes. Rezulton se 3 çështje kanë gjyqtar relator F.P dhe 2 çështje kanë gjyqtar relator K.S. Nga hetimi fizik i dosjeve nuk ka të dhëna nëse gjyqtari relator i çështjes i ka drejtuar ndonjë kërkesë subjektit të rivlerësimit për të kryer kërkime ligjore apo për të hartuar ndonjë opinion me shkrim për çështjet në proces gjykimi, nuk ka të dhëna edhe për subjektin e rivlerësimit të këty

nga Policia e Shtetit të një punonjësi policie”, me detyrë oficer i patrullës së përgjithshme shërbimi, në Seksionin e Rendit Publik, në Komisariatin e Policisë E, pranë Drejtorisë së Policisë së Qarkut E... Zgjidhjen e mosmarrëveshjes së punës ndërmjet paditësit dhe palës së paditur duke detyruar palën e paditur etj.”. Kjo çështje është përfunduar nga Gjykata Administrative e Apelit me vendimin nr. ***, datë 14.7.2016.

⁸⁰ **Dokumenti 4** – Çështja administrative nr. *** akti, datë 26.11.2015. **Dokumenti 5** – Çështja administrative nr. *** akti, datë regjistrimi 23.10.2014. **Dokumenti 6** – Çështja administrative nr. *** akti, datë 1.6.2015. **Dokumenti 7** – Çështja administrative nr. *** akti, datë 8.10.2014. **Dokumenti 8** – Çështja administrative nr. *** akti, datë 28.10.2014.

⁸¹ Ligji nr. 49/2012 neni 6, pika 2 parashikon: “Ndihmësi ligjor ndihmon dhe këshillon gjyqtarin lidhur me përgatitjen e çështjes për gjykim dhe shqyrtimin gjyqësor, si dhe përgatit projekt-akte procedurale të nevojshme për gjykimin. Me kërkesë të gjyqtarit, ndihmësi ligjor bën kërkime ligjore dhe përgatit opinione me shkrim për problematika ligjore të karakterit procedural dhe material që lidhen me çështjet në gjykim”.

bërë kërkime, formuluar projekt-akte procedurale, apo të ketë ndihmuar me këshillim gjyqtarin relator të çështjes për gjykim.

c) Komisioni, lidhur me konstatimet e bëra në pikat ii. dhe iii., bazuar edhe në nenin 6 të ligjit nr. 49/2012, kërkoi informacion⁸² në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë mbi: kërkime ligjore, hartime të opinioneve me shkrim për problematika ligjore të karakterit procedural; përgatitjen e ndonjë projekt-akti të nevojshëm për gjykim, që të mbajë nënshkrimin e subjektit të rivlerësimit në cilësinë e konceptuesit, që të dokumentojnë ndihmën dhe këshillimin e saj dhënë për gjyqtarët relatorë të çështjeve.

ç) Gjykata Administrative e Apelit Tiranë⁸³ ka informuar se *nuk rezulton të jetë miratuar ndonjë akt nënligjor me karakter normativ apo ndonjë rregullore, e cila të ketë përshkruar detyrat e ndihmësit ligjor apo hartimin e ndonjë akt të posaçëm që të mbajë nënshkrimin e ndihmësit ligjor. Znj. Misko ka ushtruar detyrën e ndihmëses ligjore nën udhëzimet dhe kërkesat e gjyqtarëve pranë të cilëve ka punuar. Gjykata nuk rezulton të ketë informacion, pasi ndihmësi ligjor kryente detyrat që i caktonte gjyqtari dhe për këtë nuk ka pasur një rregullim të caktuar ligjor, për mënyrën e ushtrimit dhe dokumentimit të detyrës të tyre.*

d) Për të njëjtin konstatim Komisioni i ka kërkuar edhe subjektit⁸⁴ shpjegime dhe nëse disponon dokumentacion ta depozitojë atë.

dh) Subjekti i rivlerësimit në përgjigjen e saj⁸⁵ fillimisht i është referuar nenit 6 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar me ligjin nr. 100/2014, i cili evidenton qartësisht veç të tjerash edhe emërimin e kategorisë së ndihmësit ligjor, si dhe detyrat funksionale të tyre në mënyrë të përgjithshme. Në zbatim të kësaj dispozite, subjekti cilëson se nuk rezulton që të jetë miratuar ndonjë akt nënligjor me karakter normativ apo ndonjë rregullore e ish-KLD-së apo Gjykatës, e cila të ketë të përshkruar në mënyrë të detajuar detyrat e ndihmësit ligjor, nuk evidentohet të jetë hartuar një akt i posaçëm procedural që të konceptohet dhe të mbajë nënshkrimin e ndihmësit ligjor, si dhe nuk ka pasur mundësi dokumentimi/protokollimi të punës që kryen ndihmësi ligjor. Subjekti sqaron se kryerja e detyrave nga ana e saj, në mënyrë të vazhdueshme ka qenë e diktuar nga kërkesat specifike që gjyqtari relator i ka paraqitur verbalisht për çështjet gjyqësore për të cilat ishte e ngarkuar. Hartimi i draft-relacionit, vendimeve procedurale, kërkimeve ligjore dhe opinioneve, si dhe hartimi i draft-vendimeve të arsyetuara u është vënë në dispozicion gjyqtarëve nëpërmjet komunikimit elektronik, *email* ose i printuar. Subjekti ka depozituar⁸⁶ *email*-e informuese dhe shpjeguese midis saj dhe gjyqtarëve relatorë për të 5 çështjet e përzgjedhura me short. Në këto *email*-e konstatohet se komunikimi ka qenë korrekt, ka të bashkëngjitur punën e kryer nga subjekti i rivlerësimit, rezulton gjithashtu se koha e *email*-eve përkon me kohën kur janë gjykuar çështjet e përzgjedhura me short. Subjekti i rivlerësimit ka depozituar një letër rekomandimi të datës 7.5.2024 nga Gjyqtari G. M., për punën e saj, si dhe disa raste të punës së saj jashtë periudhës së rivlerësimit, të cilat ajo i kategorizon në çështje me kompleksitet të lartë pune.

e) Në lidhje me etikën, Gjykata Administrative e Apelit Tiranë informon⁸⁷ se nuk rezultojnë të dhëna negative për etikën në punë të subjektit të rivlerësimit, për periudhën gjatë së cilës ka

⁸² Me shkresën nr. *** prot., datë 12.2.2024, administruar në dosjen e Komisionit.

⁸³ Me shkresën nr. *** prot., datë 16.2.2024, administruar në dosjen e Komisionit.

⁸⁴ Me pyetësit nr. 2, datë 30.4.2024, administruar në dosjen e Komisionit.

⁸⁵ Në përgjigje të pyetësit nr. 2, datë 30.4.2024, administruar në dosjen e Komisionit.

⁸⁶ Në përgjigje të pyetësit nr. 2, datë 30.4.2024, administruar në dosjen e Komisionit

⁸⁷ Me shkresën nr. *** prot., datë 20.1.2023, depozituar në raportin profesional të subjektit, administruar nga Komisioni.

ushtruar detyrën e ndihmësit ligjor pranë asaj gjykate (13.7.2015 – 8.10.2016). Gjithashtu, nga përmbajtja e shkresës së sipërcituar rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë objekt i ndonjë procedimi disiplinor për shkelje discipline.

ë) Pas kërkesës së Komisionit⁸⁸, Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, SPAK⁸⁹, informon se në emër të subjektit të rivlerësimit Majlinda Miska nuk është regjistruar ndonjë procedim penal.

- Në përfundim të analizës së kryer për 5 dokumentet e përzgjedhura me short, Komisioni nuk konstatoi problematika lidhur me vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.

39. Lidhur me kriterin e dytë vlerësues, rezultatet e testimit pranë Shkollës së Magjistraturës

39.1 Shkolla e Magjistraturës ka dërguar⁹⁰ rezultatet e testimit të aftësive profesionale për subjektet e rivlerësimit *ex officio*, të parashikuara në nenin 179/b, pika 4 e Kushtetutës⁹¹ dhe sipas parashikimeve të nenit 42 të ligjit nr. 84/2016⁹², “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, subjekti i rivlerësimit Majlinda Miska (nga verifikimi i tabelave të rezultateve) konstatohet se në fazën e parë të testimit të aftësive profesionale “testi elektronik” është vlerësuar me 45 pikë nga 100 pikë të mundshme, ndërsa në fazën e dytë “testi profesional” është vlerësuar me 113 pikë në tabelë nga 200 pikë të mundshme.

39.2 Nga verifikimi i regjistrimit të denoncimeve nuk rezultoi që të jenë depozituar ankesa nga publiku në Komision për subjektin e rivlerësimit Majlinda Miska.

Konkluzion lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni nuk u provua asnjë *indicie* apo element që cenon kriterin profesional të ndihmësit ligjor Majlinda Miska dhe, sipas parashikimeve të nenit 44/a të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, është efektive dhe efiçente në masë të pranueshme dhe, përfundimisht, u vlerësua për kriterin profesional “e aftë”.

KONKLUZION PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatores së çështjes, si dhe pasi dëgjoi subjektin në seancën dëgjimore publike, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Majlinda Miska ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

⁸⁸ Me shkresën nr. *** prot., datë 12.2.2024, administruar nga Komisioni.

⁸⁹ Me shkresën nr. *** prot., datë 22.2.2024, administruar në dosjen e Komisionit.

⁹⁰ Me shkresën nr. *** prot., datë 23.5.2018, administruar nga Komisioni.

⁹¹ Neni 179/b, pika 4 parashikon: “Të gjithë këshilltarët ligjorë pranë Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, ndihmësit ligjorë pranë gjykatave administrative, ndihmësit ligjorë pranë Prokurorisë të Përgjithshme do të rivlerësohen *ex officio*. Procesit të rivlerësimit mund t’i nënshtrohen me kërkesë dhe nëse plotësojnë kriteret sipas ligjit edhe ish-gjyqtarët, ish-prokurorët, ish-këshilltarët ligjorë të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, të cilët kanë punuar në këto pozicione të paktën tre vjet”.

⁹² Ligji nr. 84/2016, neni 42 parashikon: “Këshilltari ligjor i Gjykatës Kushtetuese, ndihmësi ligjor i Gjykatës së Lartë, Gjykatës Administrative, si dhe ndihmësi ligjor në Prokurorinë e Përgjithshme, të cilët nuk janë magjistratë, vlerësohen bazuar në: a) relacionet dhe mendimet ligjore të përgatitura; dhe b) rezultatet e testimit pranë Shkollës së Magjistraturës”.

- a. ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe në bazë të shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 58, si dhe të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Majlinda Miska, ndihmëse ligjore pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesit ndërkombëtar, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, më 24.6.2024.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Olsi KOMICI
Kryesues

Brunilda BEKTESHI
Relatore

Suela ZHEGU
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Albana Plaka